

RRJETI

“SHOQËRI CIVILE AKTIVE NË SHËRBIMET MJEDISORE NË SHQIPËRI”



“Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC në kuadër të programit SENiOR-A “Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri”. Ky program është financuar nga Qëveria Suedeze”

REC dhe Instituti i kërkimeve Urbane shpreh falënderimet dhe mirënjohjen për drejtuesit e shoqërisë civile që veprojnë në rajone të ndryshme të Shqipërisë, të cilët kontribuuan në këtë manual të përvojave dhe eksperiencave në çështjen e vlerësimit të ujit të pijshëm në Shqipëri.



MIRËNJOHJE

Studimi “Vlerësimi i aksesit të banorëve në furnizimin më ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura” i kryer në 5 bashki sipas ndarjes së re administrative, Elbasan, Vlorë, Pogradec, Gjirokastrë dhe Durrës. Ky studim u mundësua më mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze nëpërmjet Programit SENiOR-A i cili implementohet nga REC Albania.

Studimi u përgatit nga ekipi i Institutit të Kërkimeve Urbane i përbërë nga Edlir Vokopola dhe Dritan Gorica si dhe nga organizatat partnere të rrjetit të organizatave për “Vlerësimin e Shërbimeve Mjedisore në Shqipëri”, “Tjetër Vizion” e vendosur në Elbasan me drejtues Z. Arjan Çala, “Auleda” e vendosur në Vlorë me drejtuese Znj. Mirela Koçi, “Une, Gruaja” e vendosur në Pogradec me drejtuese Znj. Eleni Jajçari, “Fondacioni Gjirokastra” e vendosur në Gjirokastrë me drejtues Z. Sadi Petrela dhe “Qendra për Zhvillim Komunitar-Sot për të ardhmen” e vendosur në Durrës dhe me drejtuese Znj. Fabiola Egro Laço.

Gjithashtu për përgatitjen e këtij studimi bashkëpunuan edhe personeli i Ndërmarrjeve Ujësjetëlës-Kanalizime të këtyre qyteteve si dhe administratorëve dhe drejtorëve të shërbimeve të njësive administrative të krijuara, pa ndihmën e të cileve ky studim nuk do të ishte i mundur.

SHËNIM

“Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENiOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të REC apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e këtij publikimi”.



Instituti i Kërkimeve Urbane



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri



SWEDEN

VLERËSIMI I AKSESIT NË FURNIZIMIN MË UJË TË PIJSHËM DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA



Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	Error! Bookmark not defined.
2. Hyrje	6
3. Projekti	6
4. Pamje e përgjithshme mbi sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve	7
4.1. Administrimi i burimeve ujore	7
4.2. Reformat në sektorin e furnizimit me ujë dhe shërbimin e largimit të ujërave të ndotur 10	
4.3. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime	12
5. Metodologjia	15
6. Studim mbi gjendjen aktuale të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në bashkitë Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë, Pogradec dhe Durrës.	16
6.1. Bashkia Elbasan	16
6.2. Bashkia Vlorë	25
6.3. Bashkia Gjirokastrë	35
6.4. Bashkia Pogradec	45
6.5. Bashkia Durrës	54
7. Masa dhe rekomandime	63
8. Aneksi 1: Rezultatet e anketimit qytetar për gjendjen aktuale të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në qytetet në studim.	65
8.1. Rezultatet Elbasan	65
8.2. Rezultatet Vlorë	102
8.3. Rezultatet Gjirokastrë	141
8.4. Rezultatet Pogradec	175
8.5. Rezultatet Durrës	223
9. Aneksi 2: Rezultatet e anketimit të ndërmarrjeve UK të qyteteve në studim mbi gjendjen e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.	261
9.1. Rezultatet Elbasan	261
9.2. Rezultatet Vlorë	265
9.3. Rezultatet Gjirokastrë	269

9.4. Rezultatet Pogradec.....	271
9.5. Rezultatet Durrës.....	273
10. Aneksi 3: Foto nga aktivitetet	275

1. Hyrje

2. Projekti

Akoma vendi ynë është i ekspozuar ndaj problemeve aktuale mjedisore që lidhen me keq menaxhim të mbetjeve, mungesën e aksesit të banorëve/bizneseve me sistemin e kanalizimeve dhe derdhje të ujërave të ndotura në rrymat ujore, moskujdesjes ndaj hapësirave publike, ndotjet e mjedisit urban tej normave të lejuara etj. Gjithashtu kohët e fundit qeveria shqiptare për shkak të situatës se renduar mjedisore ka shpallur situatën e emergjencës mjedisore. Në fazën e pare dhe të dyte të programit SENiOR-A është bërë një analizim dhe vlerësim i shërbimeve mjedisore, ku nga problemet kryesore që u evidentuan ishte furnizimi më ujë të pijshëm dhe largimi i ujërave të ndotur.

Megjithëse Shqipëria është një vend shumë i pasur me rezerva ujore, uji i pijshëm ka qënë një ndër problemet më prezente për qytetarët. Furnizimi me orare të reduktuara, ulja e presionit dhe higjiena si rrjedhojë e amortizimit të rrjetit duken si probleme të cilët kërkojnë shumë investime dhe kohë që të zgjidhen. Po kështu në zona të ndryshme si pasojë edhe e ndërtimeve informale kanë pasur probleme edhe me mos furnizim me ujë të pijshëm për periudha të gjata kohe. Gjithashtu mungon dhe një sistem i automatizuar i informimit qytetar në lidhje me nivelin e aksesit të qëndrës së tyre të banuar me ujë të pijshëm.

Nën këtë kontekst, rrjeti i shoqërisë civile për menaxhimin e shërbimeve mjedisore kupton që informacioni që siguron Enti Rregullator i ujit në lidhje me sigurimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, në të dyja rastet atë Rural dhe atë Urban, si dhe studime të nevojave primare të banorëve në këto zona, ka nevojë të përmirësohet dhe të zgjerohet, në këtë mënyrë zgjidhet sfida për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe sigurohet mbrojtja e mjedisit.

Objektivat e Projektit:

- Përdorimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të rrjetit të përfituara gjatë fazës së dytë të projektit më interes informimin e qytetarëve dhe niveleve të ndryshme të qëverisjes në lidhje me nivelin dhe cilesinë e shërbimit të sigurimit të ujit të pijshëm dhe të largimit të ujërave të ndotura.
- Përditësimi dhe përmirësim i bazës së të dhënave të autoriteteve përkatëse si dhe dhënia e prioritetit të zgjidhjes së problemeve më emergjente nga këto autoritete.
- Rritja informimit publik në lidhje më ofrimit të këtyre shërbimeve nga ana e ndërmarrjeve UK sh.a.
- Mbështetje dhe përgjithësim i ekspertizës së rrjetit në vlerësimin e nivelit të aksesit të popullsisë në rrjetin e furnizimit më ujë dhe të largimit të ujërave të ndotura si dhe hartëzimi e përqindjeve të aksesit në këto shërbime.

Rezultatet afatgjata:

- Rritet bashkëpunim në rrjet për të shfrytëzuar eksperiencat dhe kapacitetet individuale
- Përmirësohen të dhënat në çdo rajon mbi shërbimin e aksesit në ujë të pijshëm dhe largimit të ujërave të ndotura.
- Rritet interesi i aktorëve për t'u përfshirë në proces vlerësimi dhe prioritizimi.
- Unifikohet informacioni mbi zonat e ndotura në 5 rajonet nëpërmjet hartëzimi të niveleve të aksesit të banoreve në këto shërbime.
- Përditësohen të dhënat lidhur me këto shërbime në bazën e të dhënave të autoriteteve përkatëse qendrore dhe vendore.


3. Pamje e përgjithshme mbi sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve

Shqipëria është e pasur me burime ujore tokësore e nëntokësore, të cilat përbëjnë një ndër pasuritë më të mëdha të vendit. Burimet ujore të përgjithshme të rinovueshme arrijnë në 41.7 miliardë metra kub ose 13,300 metra kub (m³) për frymë, nga të cilat rreth 65% gjenerohen brenda vendit, ndërsa pjesa tjetër nga ato pjesë të baseneve ujore që shtrihen në territorin e vendeve fqinje (d.m.th, Kosova, Mali i Zi, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Greqia). Burimi kryesor është uji sipërfaqësor në gjendjen e lumenjve, liqëneve dhe lagunave. Burimet nëntokësore përfaqësojnë rreth 23% të totalit të burimeve të rinovueshme. Burimet nëntokësore janë burimi kryesor i ujit të pijshëm. Sasia mesatare e ujit të pijshëm për frymë është 8,700 metër kub në vit, një ndër më të lartat në Evropë, duke treguar se kapaciteti i ujërave për përdorim publik është shumë herë më i madh se sa kërkesa për furnizimin e pandërprerë të popullsisë me ujë higjenikisht të pijshëm për 24 orë në ditë. Sigurisht që vënia në përdorim e këtyre burimeve, me qëllim furnizimin me ujë me rrjedhje të lirë, do të kërkontë ndërtimin dhe operimin e impjanteve të përshtatshme për trajtimin e ujrave sipërfaqësore, dhe investime të mëdha për t'i sjellë ato afër konsumatorit.


4.1. Administrimi i burimeve ujore

Për qëllimet e administrimit të ujrave, në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.8093, datë 21.3.1996 “Për burimet ujore”, i ndryshuar, Shqipëria ndahet në gjashtë basene ujëmbledhës hidrografike, kufijtë gjeografikë të të cilëve përcaktohen nga hartat topografike sipas vijave ujëndarëse. Autoritetet kryesore kombëtare, përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore në Shqipëri, janë Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU), Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (SK) dhe Këshillat e Baseneve.

KKU drejtohet nga Kryeministrit. Në KKU bëjnë pjesë ministrinë kryesore të linjës ku përfshihen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme si dhe gjashtë prefekturat kryesore të baseneve përkatëse të lumenjve. Në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave është ngritur Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Ujërave e cila ushtron përgjegjësitë e Sekretariatit Teknik të KKU.



Skema e autoritetit për menaxhimin e burimeve ujore në Shqipëri



Vendosja gjeografike e njësive administrative në studim

Që në vitin 2002 në vend janë krijuar në nivel vendor 6 Këshilla të Baseneve mbi bazën e 6 lumenjve kryesorë në Shqipëri, për të menaxhuar burimet ujore në basenet përkatëse. Këshillat e Baseneve janë në vartësi të Sekretariatit teknik të KKU-së, i cili përcakton kufijtë territorialë të zonave përkatëse të baseneve ujëmbledhëse në gjithë vendin, vendndodhjen, qëndrën e basenit ku dhe mbahet regjistri i ujërave.

Shfrytëzimi i rezervave ujore është objekt i vazhdueshëm kontrolli i Këshillave të Baseneve ujëmbledhës dhe i strukturave në juridiksionin e tyre. Në varësi të Kryetarit të Basenit ujëmbledhës funksionon një task forcë me detyrën për të kontrolluar dhe kërkuar zbatimin e ligjit në mënyrë të bashkërenduar dhe organizuar në të gjithë territorin e basenit. Krahë ekzekutiv i Këshillave të Baseneve janë 6 Agjensitë e Baseneve Lumore, të cilat janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve për menaxhimin e baseneve ujëmbledhëse.

Njësitë Vendore në Studim			
Nr	Bashkia	Njësi	Komuna
1	Vlorë	4	
	Qyteti		Novoselë Qëndër Orikum
2	Pogradec	8	
	Qyteti		Buçimas Çerrave Dardhas Velçan Propisht Hudenisht Trebinje
3	Elbasan	6	
	Qyteti		Labinot Fushë Paper Gjergjan Bradashesh Shushice
4	Durrës	6	
	Qyteti		Ishëm Sukth Maminas Katund i ri Rrashbull
5	Gjirokastër	7	
	Qyteti		Picar Cepo Lazarat Antigone Lunxheri Odrie

4.2. Reformat në sektorin e furnizimit me ujë dhe shërbimin e largimit të ujërave të ndotur

Që nga viti 1996, në përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar punën e furnizimit me ujë dhe shërbimet e UN, qeveritë e njëpasnjëshme në Shqipëri kanë ndërmarrë reforma që përfshijnë shumë aspekte, të cilat përgjithësisht i referohen praktikave më të mira nga vende të tjera, por që jo domosdoshmërisht i kanë arritur në ato standarde. Reforma e këtij sektori në Shqipëri është orientuar në tre drejtime, të cilat përbëjnë njëkohësisht edhe tre faza të njëpasnjëshme të zhvillimit historik të pas viteve '90.

Qëveria e kohës vendosi të transformojë organizimin e ndërmarrjeve/operatorëve shtetërorë të shërbimit si shoqëri anonime me 100% të aksioneve pronë shtetërore, në mënyrë që të ofrojë mundësinë e përmirësimit të administrimit korporativ të sektorit, lehtësuar privatizimin, dhe siç rezultoi në vijim, transferimin e aksioneve të këtyre shoqërive në njësitë e qeverisjes vendore.

Kjo reformë u shoqërua me krijimin Entin Rregullator të Ujit (ERRU) në vitin 1998, si një institucion i pavarur, me qëllim liçensimin e operatorëve, përmirësimin e cilësisë dhe te eficiences operative në sektor, vendosjen e standardeve dhe rregullimin e sektorit, miratimin e çmimit të shërbimeve dhe mbrojtjen e konsumatorëve, të nxisë konkurrencën dhe të sigurojë transparencën në raport me konsumatorët.

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është institucion i pavarur publik, i krijuar me ligj, për rregullimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura. ERRU është ngritur dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 8102, dt. 28.03.1996, për “Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar me ligjin nr. 9352, datë 03.03.2005, ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, si dhe ligjin nr. 9915, datë 12.05.2008.

ERRU udhëhiqet nga Komisioni Kombëtar Rregullator, i cili ushtron këto kompetenca të përgjithshme:

- ✓ Jep licenca për entet komerciale që janë të angazhuara në kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të përdorura;
- ✓ Miraton çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit të ofruar nga operatorët që sigurojnë ujë për konsum publik, edhe në ato raste kur sistemet e ujësjellës-kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose pronësi të njësive të qeverisjes vendore;
- ✓ Inkurajon standarde dhe rregulla uniforme për të gjithë sektorin;

Licensimi i operatorëve të shërbimit

Në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, bazuar në vendimet e transferimit të aksioneve në pronësi të njësive vendore, VKM nr 660 datë 12.09.2007, VKM nr. 81 datë 12.02.2004, VKM nr. 173 datë 26.03.2004 dhe VKM nr. 809 datë 26.11.2004, janë regjistruar 59 shoqëri/ndërmarrje, prej të cilave 57 janë shoqëri anonime dhe 2 janë me statusin e ndërmarrjeve publike, gjithsesi në proces transformimi.

Gjatë vitit 2014 kanë aplikuar për pajisje me licencë apo rinovim licence, 22 shoqëri ujësjellës kanalizime, nga të cilat pas plotësimit të gjithë dokumentacionit të kërkuar, kanë kaluar për

vendimmarrje në KKRR dhe janë licencuar 13 (trembëdhjetë) operatorë, ndërsa 9 (nëntë) aplikime të tjera mbeten ende në proces.

Po gjatë këtij viti, kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR dhe janë licencuar dhe 2 (dy) shoqëri të tjera, aplikimet e të cilave vinin nga viti paraardhës, por që dokumentacioni u plotësua nga shoqëritë në vitin 2014. Aplikimet e mësipërme kanë ardhur nga 14 (katërmbëdhjetë) shoqëri si pasojë e përfundimit të afatit të licencës, nga 5 (pesë) shoqëri si pasojë e ndryshimit të drejtuesit ligjor/teknik, nga 1 (një) shoqëri si pasojë e shtimit të kategorisë së grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura dhe nga 1 (një) shoqëri si pasojë e ndryshimit të formës ligjore dhe pronësisë. Kjo shoqëri është ujësjellës-kanalizime Elber sh.p.k., deri më tani me pronar Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, e cila u transformua në një shoqëri aksionare, ujësjellës-kanalizime Elbasan sh.a. me pronar Bashkinë Elbasan.

Gjatë procesit të aplikimeve për pajisje me licencë apo rinovim licence gjatë vitit 2014, nga ana e shoqërive që operojnë në sektorin UK, u hasën përsëri problematika që janë të njohura për ERRU-në. Ndër to, si më kritike, mund të përmendim:

- Ndryshimi i drejtuesit ligjor/teknik brenda një periudhe shumë të shkurtër (dhe disa herë brenda një viti), rreth 12 raste, ku mund të përmendim sh.a UK Durrës, sh.a UK Librazhd, sh.a UK Fushë Krujë, sh.a U Ura Vajgurore, sh.a U Novoselë, etj
- Vështiresi në gjetjen e një drejtuesi të dytë për shoqëritë që kanë në funksionim impiante;
- Vështirësi për shlyerjen e pagesës së licencimit tek ERRU nga pothuajse të gjitha shoqëritë;
- Vështirësi në regjistrim dhe reflektimin e ndryshimeve në QKR, rreth 6 raste, ku mund të përmendim sh.a U Rrëshen, sh.a UK Mallakastër, sh.a UK Këlcyrë sh.a UK Kukës, sh.a UK Fushë Arrëz, sh.a U Has;
- Vonesa në dorëzimin e dokumenteve të nevojshme nga ana e shoqërive për nisjen e procedurës së licencimit, pothuajse nga të gjitha shoqëritë. Kryesisht vonesa ka pasur në marrjen e aktit të miratimit higjieno-sanitar, lejet e mjedisit (në rastin e kategorisë së përpunimit të ujërave të ndotura), autorizimit nga pronari, dëshmitë e penalitetit,
- por nuk mungojnë rastet kur dokumentacioni vonohet si pasojë e neglizhencës nga ana e shoqërisë.

ERRU si institucion ka qënë gjithmonë bashkëpunues dhe i gatshëm për të ndihmuar dhe mbështetur shoqëritë në zgjidhjen e këtyre problemeve.

Për shkak të problematikave të paraqitura më sipër, situata e licencimit deri në fund të vitit 2014, për 57 shoqëritë UK që operojnë në sektorin ujësjellës-kanalizime është si më poshtë:

- 40 (dyzet) operatorë disponojnë licenca të vlefshme;
- 9 (nëntë) operatorë janë në proces të rinovimit të licencës
- 5 (pesë) operatorë u ka përfunduar afati dhe nuk kanë aplikuar akoma për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për licencim;
- 3 (tre) operatorë janë pa licencë.

Vendosja e tarifave

ERRU miraton tarifat e shërbimit vetëm për ata operatorë të cilët janë të licënsuar nga ky institucion. Objektivi kryesor i ERRU në procesin e miratimit të tarifave është gjetja e balancës ndërmjet mbrojtjes së interesit të konsumatorëve në të njëjtën kohë me rritjen e qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit. Në këtë kontekst, në vendosjen e tarifave ERRU udhëhiqet nga vlerësimi i performancës së operatorëve, si dhe nga synimi për përmbushjen e direktivës evropiane për mbulimin e kostos operative dhe në vijim të kostos totale të operacioneve për realizimin e këtyre shërbimeve. Sipas raportit të ERRU për vitin 2011, tarifa mesatare për konsumatorët familjarë është 36 Lekë/m³ me një rritje mesatare prej rreth 16%, ndërsa tarifa mesatare për shërbimin e largimit dhe/ose trajtimit të ujërave të ndotura është mesatarisht 11 Lekë/m³ ose rreth 27% më shumë se në vitin 2010. Tarifat e miratuara në vitin 2011 kanë synuar mbulimin e kostove në rritje.

Vendosja e Standardeve

Një nga kompetencat kryesore të Komisionit Kombëtar Rregullator është krijimi dhe garantimi i standardeve të punës për të licencuarit dhe rregullave uniforme për të gjithë sektorin. Gjatë vitit 2011 Komisioni Kombëtar Rregullator ka hartuar disa rregulla uniforme dhe ka ndërmarrë disa iniciativa të rëndësishme si më poshtë:

- ▶ Miratimi i Kontratës Model për shërbimet ujësjellës kanalizime, ndërmjet konsumatorit dhe operatorëve të licencuar në këtë sektor.
- ▶ Metodologjia për vendosjen e tarifave.
- ▶ Manuali për Anëtarët e Këshillave Mbikëqyrës në lidhje me shërbimet e sektorit ujësjellës-kanalizime.
- ▶ Zbatimi i rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizime në zonën e shërbimit të operatorëve (Kodi i Ujit), që synon: përcaktimin e rregullave dhe kërkesave që duhet të përmbushin operatorët e shërbimit për një shërbim sasior dhe cilësor në sektor; krijimin e një marrëdhënie të re ligjore ndërmjet pronarëve të aseteve (njësive të qeverisjes vendore) dhe administratorëve të këtyre aseteve.
- ▶ Studimi kombëtar rreth Shërbimeve për klientin në shoqëritë ujësjellës kanalizime. Ecuria e treguesve përbën bazën mbi të cilën vlerësohet shërbimi që ofron i licencuari, si dhe përcaktimi i duhur i kërkesës për ndryshim tarife nga ana e tij.

4.3. Mbulimi me shërbimin e furnizmit me ujë dhe kanalizime

Që nga viti 2005 në DPUK funksionon Njësia e Monitorimit të Treguesve të Punës dhe Vlerësimit Krahasimor (NjM) e cila ka ndërtuar një sistem të dhënash dhe prodhon rregullisht raporte vjetore me indikatorë të cilët përcaktojnë performancën e 57 shoqërive që monitorohen nga ky sistem.

Indikatorët e mbulimit me shërbimin e furnizmit me ujë dhe ujrat e ndotura përgjithësisht evidentohen si raporti i popullsisë së shërbyer në zonat e juridiksonit të shoqërive ndaj totalit të popullsisë. Burimi i të dhënave, veçanërisht popullsia, mbi të cilat llogariten këto indikatorë janë operatorët e shërbimit, të cilat shpesh nuk i referohen ndonjë burimi të çertifikuar, siç mund të jëtë Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.


Gjithsesi, në këtë seksion Konsulenti do t'i referohet vetëm të dhënave që publikohen nga ERRU në raportet vjetore të performancës, duke evituar mospërputhjet që evidentohen veçanërisht në

shifrat që kanë të bëjnë me numrin e popullsisë në përgjithësi. Për qëllimet e këtij seksioni të raportit për numrin total të popullsisë do të referohemi me atë që është publikuar nga Strategjia e Sektorit për vitet 2011 – 2017.

Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë

Nga Njësia e Monitorimit në DPUK raportohet se shoqëritë/operatorët e shërbimit mbulojnë me shërbimin e furnizimit me ujë një popullsi prej 2,65 milion banorë ose rreth 80,3% të popullsisë në zonën e juridiksionit të tyre e cila përbëhet nga rreth 3,31 milion banorë.

Siç është theksuar nga Strategjia e Sektorit për vitet 2011 – 2017, ashtu siç dhe do ta gjejmë më poshtë nga analiza e rasteve konkrete të shoqërive të përfshira në këtë studim, evidentohet fakti se ka një mospërputhje ndërmjet popullsisë që deklarohet e mbuluar me shërbim, ndaj asaj faktike të rregjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.



Harta e zonave të mbuluara me shërbimin e furnizimit me ujë\

Kjo mospërputhje gjendet veçanërisht në popullsinë rurale të komunave, si diferencë e popullsisë totale të komunës dhe shumës së popullsisë së fshatrave për efekt të numrit të fshatrave që realisht mbulohen me shërbim.


Në këtë kontekst, ERRU duhet të krijojë një instrument që mbledh të dhëna edhe për sistemet e ujësjellsave dhe të UN që funksionojnë jashtë zonës së shërbimit të 57 shoqërive, si edhe për sistemet e kanalizimeve që funksionojnë brenda zonës së shërbimit të këtyre shoqërive, por që administrohen nga operatorë të tjerë, kryesisht nga NJQV-të. Të gjitha këto të dhëna duhet të jenë pjesë e programit për raportimin e të dhënave dhe duhet të administrohen nga ERRU.

Për pjesën tjetër të popullsisë, shërbimi i furnizimit me ujë administrohet nga sektorë që veprojnë brenda strukturave organizative të NJQV-ve, dhe në disa raste nga individë, persona fizikë dhe/ose juridike që operojnë ose jo në kontratë me njësitë vendore, por që nuk janë të licencuar nga ERRU sipas ligjit në fuqi. Në përgjithësi çdo operator në Shqipëri e siguron furnizimin me ujë nga dy ose më shumë sisteme, të cilat mund të jenë me rrjedhje të lirë, me ngritje mekanike ose të kombinuar. Prodhimi nga sistemet me rrjedhje të lirë zë vetëm 9% të totalit të ujit të prodhuar dhe pjesa tjetër prodhohet nga sistemet me ngritje mekanike dhe të kombinuara. Aktualisht, sasia e ujit të prodhuar mbulon kërkesën për ujë të të gjithë konsumatorëve.

Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve të ujrave të ndotura

Shërbimi i kanalizimeve të UN për shumicën e operatorëve nënkupton grumbullimin dhe largimin e ujërave të ndotura dhe i ofrohet kryesisht klientëve në zonat urbane dhe në një përqindje shumë të vogël popullsisë në zonat rurale, ndërsa trajtimi i tyre kryhet vetëm nga dy operatorë. Gjendja e mbulimit me shërbimin e UN, në tërësi analizohet nga ERRU nëpërmjet disa treguesve kryesor të performancës, të cilët raportohen nga Njësia e Monitorimit në DPUK.

Nga raporti vjetor i ERRU për vitin 2014 raportohet se shoqëritë/operatorët e shërbimit mbulojnë me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të ujrave të ndotura një popullsi prej 1,65 milion banorë ose rreth 64,6 % të popullsisë në zonën e juridiksionit të tyre (3,31 milion banorë). Popullsia që faktikisht shërbehet me kanalizime nga operatorët jeton kryesisht në zonat urbane dhe përbën 83,0 % të totalit të popullsisë që shërbehet, dhe pjesërisht në zonat rurale me një mbulim prej 10,9 % të totalit të popullsisë në zonën e mbulimit me shërbim. Këto të dhëna konfirmohen edhe kur i referohemi Raportit Vjetor 2014 të ERRU.



Harta e zonave të mbuluara me shërbimin e kanalizimeve

4. Metodologjia

Ndikimi i rrjetit për përmirësimin e ujit dhe ndikimin në komunitet, vecanërisht tek gratë. Duke qënë se nga gjetjet e monitorimit mbi shërbimet publike dhe analizimi i kampionit të ujit, shërbimet e ujit të pijshëm dhe largimi i ujrave të ndotura, rezultuan si domosdoshmëri për një monitorim të dyte të detajuar, rrjeti i shërbimeve mjedisore në këtë fazë është duke analizuar pikërisht këto domosdoshmëri në një analizë më të thelluar.

Ky studim bazohet në intervista të drejtpërdrejta, të cilat janë realizuar bazuar në pyetësor drejtuar qytetarëve si dhe drejtuesve të ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizime të qyteteve organizatat e të cileve janë anetare të rrjetit për vlerësimin e shërbimeve mjedisore në Shqipëri. Ky pyetësor na siguron të dhëna në lidhje me aksesin në furnizimin me ujë të pijshëm dhe cilësinë e ujit, pasi janë pak të njohura problematikat e ujit lidhur me cilësinë e tij dhe qytetarët nuk kanë informacionin e nevojshëm për shërbimet e ujit.


Për këtë arsye, u shpërndanë 100 pyetësorë në këto zona dhe u bë një vlerësim dy javor duke zgjedhur familjet në mënyrë të rastësishme për mbushjen e këtyre pyetësorëve, dhe me pas u bë analizimi i të gjitha të dhënave duke nxjerrë përfundime në lidhje me cilësinë aktuale të qyteteve të analizuar për problemet e sipërpërmendura.

5. Studim mbi gjëndjen aktuale të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në bashkitë Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë, Pogradec dhe Durrës.

Në këtë seksion do të bëhet një pasqyre e përgjithshme e gjendjes aktuale të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm si dhe të largimit të ujërave të ndotur urban në qytetet në studim. Rezultatet e këtij paragrafi janë një paraqitje e përmblendhur e rezultateve të anketimit (Aneksi 1). Këto rezultate janë përpunuar sipas teknologjisë së Sistemit të Infomarcionit Gjeografik (GIS), për të evidentuar perceptimin qytetar në të gjithë zonën e re funksionale.


6.1. Bashkia Elbasan

Bashkia Elbasan shtrihet dhe përfshin 13 njësi ekzistuese të qeverisjes vendore, Elbasan, Labinot-Fushë, Labinot Mal, Gjinar, Shushicë, Gjergjan, Funar, Shirgjan, Tregan, Gracen, Bradashesh, Papër, Zavalinë, me një popullsi gjithsej prej 202 948 banorë, sipas të dhënave të Regjistrat Civil. Sipërfaqja është 872 km² dhe dendësia e popullsisë 162 banorë/km². Në studimin tonë të limituar nga sipërfaqja e madhe e bashkisë se reformuar janë zgjedhur disa njësi administrative siç janë Paper, Bradashesh, Gjergjan, Labinot Fushë, Shushicë dhe Qendra e Qytetit.




Gjendja aktuale e shërbimit me ujë të pijshëm në bashkinë Elbasan sipas përgjigjeve që kanë dhënë banorët e këtij qyteti tregon se në shumicën e rasteve banorët kanë furnizim me ujë në pjesën më

te madhe te ditës. Dhe nje pjese e konsiderueshme e tyre sidomos ne njesite administrative Paper, Gjergjan dhe Labinot Fushe ata shprehen se koha me te cilën ata furnizohen me uje te pijeshem arrin ne 24 ore ne dite, kjo gjithashtu eshte si rrjedhoje e investimit personal te te intervistuarëve duke blere pajisje ndihmese sic janë depozitat e ujit ose edhe pompat mekanike per sigurimin e ujit.




Persa i përket mënyrës se furnizimit me uje banoret e intervistuar me se shumti janë shprehur se se ata furnizohen nga rrjeti i furnizimit me uje i ofruar nga Bashkia/Komuna me përjashtim te banoreve ne njesite administrative Paper dhe Gjergjan te cilët shprehen se ata furnizohen nga burime alternative te furnizimit me uje.

KËNAQSHMËRIA ME SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË




Ne lidhje me kënaqshmerine me shërbimin e furnizimit me uje te pijshëm ne Bashkine Elbasan, banoret ne përgjithësi janë përgjigjur se janë deri diku te kënaqur me kete shërbim, difference paraqet njësia administrative Bradashesh dhe Labinot Fushe ku pjesa me e madhe e banoreve janë përgjigjur se janë te kënaqur me shërbimin e furnizimit me uje te pijshëm. Ne njësinë administrative Paper dhe Gjergjan gjithashtu ka qene nje numër i konsiderueshëm banorësh te cilët janë përgjigjur se nuk janë aspak te kënaqur me kete shërbim dhe se kërkojnë ndërhyrjen e menjëhershme per përmirësimin e kësaj situatë.

PËRDORIMI I DEPOZITAVE TË UJIT




Persa i përket përdorimit të depozitave në Bashkinë Elbasan pjesa më e madhe e banorëve të qytetit, njësisë administrative Paper dhe asaj Bradashesh janë përgjigjur se disponojnë dhe përdorin një depozitë për ruajtjen e ujit për oraret kur ai mungon. Ndërsa pjesa më e madhe e banorëve në njësitë e mbetura administrative të cilat shfaqin një tipologji rurale shprehin se nuk disponojnë depozitë ujë.

MËNYRA ALTERNATIVE E FURNIZIMIT ME UJË




Per ata banore te cilët janë përgjigjur se ne shtëpitë e tyre nuk janë te lidhur me rrjetin e furnizimit me uje në hartën e mesiperme vihet re se menyra alternative e perdorur prej tyre është duke krijuar puse private dhe duke marre uje prej andej si dhe duke perdorur burime natyrore që mund të ndodhen në lagjen ose fshatin e tyre.

PROBLEMATIKAT LIDHUR ME ERËN E KEQE TË UJIT




Një nga seksionet e pyetësorit i cili i është paraqitur banoreve ka qenë i lidhur me problematikat kryesore të cilat lidhen drejtpërdrejt me shëndetin e personave të cilët konsumojnë këtë ujë. Përsa i përket problematikave lidhur me erën e keqe të ujit shumica e banoreve në të gjithë bashkinë e reformuar të Elbasanit janë përgjigjur se e kanë hasur rralle ose kurrë këtë fenomen më përjashtim të disa prej të intervistuarve në zonën e Shushicës të cilët janë përgjigjur se këtë problematikë ata e hasin shpesh në shtëpinë e tyre.

PROBLEMATIKAT LIDHUR ME NGJYRËN E UJIT




Përsa i përket problematikave lidhur me ngjyrën e ujit të intervistuarit sikurse në rastin e parë janë përgjigjur më së shumti se nuk kanë probleme të tilla me cilësinë e ujit duke dhënë përgjigje se këtë fenomen e hasin rrallë ose kurrë. Sikurse në rastin e sipërm në njësinë administrative Shushice ka patur nga ata banorë të cilët janë përgjigjur se shpesh herë e hasin këtë problem në shtëpitë e tyre.




Një kapitull të vecante në pyetesor ka patur dhe sistemi largimit të ujerave të ndotur në bashkine e reformuar Elbasan. Për këtë arsye të pyetur për menyrat e largimit të ujerave të ndotur urban personat e intervistuar janë pergjigjur në shumicen e rasteve se sherbimin e largimit të ujerave të ndotur urbane e marrin nga instancat pergjegjese të ofrimit të ketij sherbimi ndersa në njesine administrative Paper banorët e pyetur janë pergjigjur se këtë sherbim e sigurojne më ane të gropave sepike. Ndersa problematike paraqitet gjendja në njesite administrative Bradashesh dhe Shushice të cilet pranojne se për largimin e ujerave të ndotur urbane janë detyruar të nderhyjne në sistemin e largimit të ujerave të ndotur në menyre të paligjshme.

KËNAQSHMËRIA ME SHËRBIMIN E LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTUR



Përsa i perket kenaqshmerise që banorët kanë në lidhje më sherbimin e largimit të ujerave të ndotur shumica e banorëve shprehen se janë të kenaqur ose deri diku të kenaqur më sherbimin e largimit të ujerave të ndotur, më perjashtim të banoreve të njesise administrative Gjergjan të cilet janë pergjigjur se nuk janë aspak të kenaqur më sherbimin e largimit të ujerave të ndotur.


PROBLEMATIKAT LIDHUR ME UJIN E PIJSHËM DHE KANALIZIMET




Lidhur më problematikat në përgjithësi që banorët kanë hasur në lidhje më ujin e pijshëm dhe kanalizimet ata janë pyetur për disa problematika siç mund të jenë mungesa e aksesit në ujë të pijshëm mungesa e aksesit në sistemin e kanalizimeve kushte të papërshtatshme higjienike etj, sipas hartës së mesipërme vëmë re se problematikat më të mëdha që hasin banorët e bashkisë Elbasan janë të lidhura më kushtet e papërshtatshme higjienike si dhe më mungesën e rrjetit të kanalizimeve.

6.2. Bashkia Vlorë


Bashkia Vlorë përbëhet nga njësitë administrative Novoselë, Shushicë, Qendër, Orikum dhe Vlorë me një popullsi prej 104 827 banorësh, sipas të dhënave nga Censusi i vitit 2011.




Furnizimi me ujë të pijshëm në Bashkinë Vlorë është kryesisht i njësuar. Banorët mbulohen në pjesën më të madhe përmes një ndërmarrjeje shtetërore. Në njësitë Qendër dhe Orikum, për një pjesë të popullatës vepron ndërmarrja në varësi të njësisë administrative.



Ndërsa shërbimi është i njësuar, një pjesë e konsiderueshme e banorëve të Bashkisë Vlorë shprehen aspak të kënaqur me këtë shërbim, veçanërisht në qytetin e Vlorës dhe njësitë Qendër e Novoselë. Përfshijm bën njësia Orikum, ku banorët shprehen të kënaqur ose deri diku të kënaqur.




Në Bashkinë Vlorë, thuhet se e gjithë popullata përdor depozitat e ujit të pijshëm, me përjashtime shumë të vogla që reflekton në orarin e furnizimit me uje në këtë qytet. Sipas banoreve ata kanë një furnizim 24 orësh me uje nga sistemi i furnizimit me uje.




Nga harta e formave të furnizimit me ujë rezulton së një pjesë e vogël e banorëve të Bashkië Pogradec furnizohen me ujë të pijshëm përmes formalve alternative. Për këtë pjesë të banorëve, këto forma specifikohen në hartën e mësipërme. Kështu, rezulton se burimi kryesor alternativ janë pusët vetjake të banorëve; në njësinë Qendër, një pjesë jo e vogël e popullatës shprehen se e blejnë ujin e pijshëm.

PROBLEMATIKAT LIDHUR ME ERËN E KEQE TË UJIT



Për pjesën më të madhe të popullatës në Bashkinë Vlorë, problemi i erës së keqe të ujit ndeshet ndonjëherë ose shpesh. Në njësinë Qendër një përqindje e banorëve pohojnë se ky problem ndeshet gjithnjë. Gjendja duket të jetë më e mirë për njësinë Orkum, ku banorët pohojnë se nuk kanë kurrë probleme me erën e keqe të ujit ose kanë vetëm ndonjëherë.


PROBLEMATIKAT LIDHUR ME SHIJEN E KEQE TË UJIT




Nga anketimi rezulton së në Bashkinë Vlorë, qyteti i Vlorës, njëisa administrative Qendër dhe Novoselë kanë probleme me shijen e keqe të ujit të pijshëm: shpesh dhe ndonjëherë – në masë të parafërt, ose gjithashtu rrallë.

Vërehet së në Orikum, përgjigjet e banorëve janë thujse të kundërta, pjesa më e madhe pohojnë se nuk e ndeshin kurrë këtë problem por, nga ana tjetër, një pjesë e ndjeshme pohojnë se shija e keqe e ujit të pijshëm ndeshet shpesh në zonën e tyre.

PROBLEMATIKAT LIDHUR ME NGJYRËN E UJIT




Ngjyra e ujit, në Bashkinë Vlorë, është një problem që nuk ndeshet kurrë në njësitet Orikum dhe rrallë në Novoselë. Më problematike në këtë drejtim duket se janë qyteti i Vlorës dhe njësia Qendër, ku është jo e vogël pjesa e banorëve që pohojnë se problemin e ngjyrës së ujit e ndeshin ndonjëherë, shpesh apo dhe gjithnjë.




Përsa i perket menyres se largimit të ujerave të ndotur urban në zonen e qyteti dhe në njesine administrative Orikum largimi i ujerave të ndotura sigurohet më se shumti nga operatori shtetëror pergjegjes për këtë shërbim, ndërsa në njesine administrative Qender dhe Novosele më se shumti largimi i ujerave të ndotur kryhet më grope septike dhe rrjedhje të lire.

KËNAQSHMËRIA ME SHËRBIMIN E LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTUR




Sipas qytetareve shërbimi i largimit të ujerave të ndotur urban le për të dëshiruar pasi në përgjigjet e tyre dominon përgjigja se ata janë aspak të kënaqur me këtë shërbim. Kjo situatë vëhet re në të gjithë bashkinë por në qendren e qytetit Vlorë kjo ndjeshmëri është akoma dhe më e theksuar. Sipas tyre kërkohej një ndërhyrje e menjëhershme pasi në disa raste si pasojë e rrjedhjeve të ujerave të ndotur urbane bashkohen me sistemin e transportimit të ujit të pijshëm dhe shkakton probleme shëndetësore.



Lidhur me problematikat që shfaqin banorët në lidhje me sektorin e Ujesjelles Kanalizime një nga problematikat që është lakuar më së shumti nga banorët është peroblematika lidhur me kushtet e papershtatshme higjienike e ujit të pijshem ndersa në njesine administrative Novosel një pjesë e konsiderueshme e banoreve janë pergjigjur gjithashtu se kanë probleme aksesin në sistemin e largimit të ujerave të ndotur.


6.3. Bashkia Gjirokastrër

Bashkia Gjirokastrër përfshin njësitë administrative Picar, Odrie, Cepo, Lunxhëri, Antigone, Lazarat dhe qytetin e Gjirokastrës, me një popullsi prej 28 673 banorësh, sipas të dhënave nga Censusi i vitit 2011.




Gjendja aktuale e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm në bashkinë Gjirokastrë sipas banorëve të pyetur për këtë studim të cilët rreth 50 e tyre janë shprehur se furnizohen me ujë të pijshëm nga ndërmarrja Komunale/Bashkiake. Ndërsa pjesa tjetër e banorëve nuk janë përgjigjur, gjë që tregon se këta banorë kanë alternativa të tjera të furnizimit me ujë në shtëpitë e tyre.

KËNAQSHMËRIA ME SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË




Nga të dhënat e anektimit, në njsitë administrative Picar, Odrë dhe Lunxhëri, banorët janë në pjesën më të madhe të pakënaqur me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm. Një pjesë jo e vogël banorësh në njësitë Cepo dhe Antigone shprehen gjithashtu aspak të kënaqur. Nga ana tjetër, në njësinë Antigone, një pjesë tjetër banorësh, që përbën pjesën më të madhe, janë shprehur shumë të kënaqur me këtë shërbim. Në Lazarat, thuajse e gjithë popullata është e kënaqur me shërbimin.




Banorët e anketuar në Bashkinë Gjirokastrë pohojnë në pjesën më të madhe se përdorin depozita për furnizimin me ujë të pijshëm, veçanërisht në qytetin e Gjirokastrës, në Lazarat e Antigone. Depozitat përdoren më pak në Capo, Odrie dhe Lunxhëri.

MËNYRA ALTERNATIVE E FURNIZIMIT ME UJË




Pjesa e banorëve të Bashkisë Gjirrokastër të cilët kanë mënyra alternative të furnizimit me ujë të pijshëm pohojnë se këto alternativa janë burimet natyrore, kryesisht në njësinë administrative Lazarat, çezmat publike, në njësinë Odrle, dhe puset private në disa prej njësive. Në njësinë administrative Picar, një pjesë e banorëve pohojnë se e blejnë ujin e pijshëm.

PROBLEMATIKAT LIDHUR ME ERËN E KEQE TË UJIT




Banorët e anketuar në Bashkinë Gjirokastrë kryesisht pohojnë se nuk ndeshin kurrë probleme me erën e keqe të ujit të pijshëm. Një pjesë më e vogël banorësh në njësitet Picar, Odrje e qytetin e Gjirokastrës pohojnë se e kanë shpesh këtë problem.

PROBLEMATIKAT LIDHUR ME SHIJEN E KEQE TË UJIT




Gjithashtu, shija e keqe e ujit për pjesën më të madhe të banorëve të anketuar, nuk ndeshet kurrë ose ndeshet rrallë. Përsëri në njësinë Odrri, një pjesë e banorëve pohojnë se kanë shpesh probleme me shijen e keqe të ujit të pijshëm me të cilin furnizohen.

PROBLEMATIKAT LIDHUR ME NGJYRËN E UJIT




Gjendja në lidhje me ngjyrën e ujit të pijëshëm pasqyrohet gjithashtu e ngjashme; banorët e anektuar shprehen se nuk e ndeshin kurrë këtë problem, ose e ndeshin rrallë. Një pjesë e vogël banorësh në disa njësi, edhe në qytetin e Gjirokastrës, pohojnë se ndeshin shpesh probleme me ngjyrën e ujit me të cilin furnizohen.

MËNYRA E LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTUR




Sipas të dhënave të anketimit, largimi i ujrave të ndotur në Bashkinë Gjirokastrë, kryhet në pjesën më të madhe të njësive administrative nga vetë banorët me grope septike. Në qytetin e Gjirokastrës dhe njësinë Lazarat shërbimi kryhet nga operatorë shtetëror. Në pak raste, banorët pohojnë se ujërat e ndotur në zonën e tyre largohen me rrjedhje të lirë.

KËNAQSHMËRIA ME SHËRBIMIN E LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTUR



Për këto forma shërbimi të largimit të ujrave të ndotur, banorët e anketuar shprehen kryesisht aspak të kënaqur ose deri diku të kënaqur, si në njësitë ku veprojnë operatorë shtetërorë ashtu dhe aty ku shërbimi kryehet përmes gropave septike. Megjithatë, në njësinë administrative Odrie, thuajse të gjithë banorët shprehen të kënaqur me largimin e ujrave të ndotur përmes gropave septike. Në qytetin e Gjirokastrës, pjesa më e madhe e banorëve të anketuar pohojnë se janë shumë të kënaqur me shërbimin.

PROBLEMATIKAT LIDHUR ME UJIN E PIJSHËM DHE KANALIZIMET




Në tërësi, problematikat në lidhje me ujin e pijshëm dhe largimin e ujrave të ndotur ndeshen në masë të përafërt në Bashkinë Gjirokastrë, bazuar në përgjigjet e banorëve të anketuar. Në mënyrë të veçantë në njësinë Lazarat, pjesa më e madhe e tyre theksojnë se nuk ka akses në ujë të pijshëm. Vetëm një pjesë e vogël e banorëve të anketuar në të gjithë Bashkinë pohojnë se tarifa është e papërbalueshme. Largimi i ujrave të ndotur, është një problem më i theksuar në qytetin e Gjirokastrës dhe njësinë Antigone, krahasuar me problematikat e tjera që u janë parashtruar banorëve të anketuar.


6.4. Bashkia Pogradec

Bashkia Pogradec përfshin 8 njësi administrative. Qendra urbane e kësaj zone është qyteti i Pogradecit, ndërsa njësitë Udenisht, Buçimas, Çërravë, Dardhas, Trebinjë, Proptisht dhe Velçan janë kryesisht zona bujqësore fushore, malore ose të përziera. Popullsia gjithsej është 61 530 banorë, ku popullsia rurale zë 66% të totalit ndërsa popullsia urbane 34 % të totalit, e përqendruar kryesisht në qytetin e Pogradecit.


Katër nga tetë njësi në këtë zonë kanë një popullsi më të vogël se 5 000 banorë. Zona më e populluar shtrihet përgjatë bregut të liqenit të Ohrit. Bashkia ka një sipërfaqe totale prej 497 km² ose 9,29 km² për 1000 banorë.




Bashkia Pogradec furnizohet me ujë të pijshëm kryesisht përmes bashkisë dhe njësive administrative. Shërbimi kryhet nga ndërmarrje private për një pjesë të konsiderushme të popullatës vetëm në njësinë Trebinjë. Ndërmarrjet shtetërore kryesisht mbulojnë pjesë të qytetit të Pogradecit dhe njësisë Proptisht. Në njësinë Çërravë, pjesërisht në Dardhas dhe Propishtë popullsia merr ujë të pijshëm në forma alternative, me organizim vetjak.



Pjesa më e madhe e banorëve të Bashkisë Pogradec shprehen të kënaqur me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm. Në njësitë Proptisht dhe Velçan pjesa e banorëve të cilët shprehen aspak të kënaqur është e ndjeshme. Gjithashtu, në të gjitha njësitë e tjera, me përjashtim të qytetit të Pogradecit, ka një pjesë të vogël, por jo të pa konsiderueshme, banorësh që shprehen aspak të kënaqur me shërbimin.




Depozitat e ujit të pijshëm janë të përhapura në njësitë administrative Udenisht, Velçan, Dardhas dhe Çerravë, për pjesën më të madhe të banorëve të tyre, ndërsa nuk përdoren në pjesën tjetër të Bashkisë Pogradec. Veçanërisht në qytetin e Pogradecit, depozitat e ujit të pijshëm nuk janë fare të përdorura nga banorët.




Për pjesën e banorëve të cilët furnizohen me ujë të pijshëm përmes formave alternative vetjake, këto forma specifikohen në hartën e mësipërme. Për Bashkinë Pogradec, forma mbizotëruese janë burimet natyrore në pjesën më të madhe të njësive administrative. Në njësinë Çerravë banorët përdorin puset private, të cilat janë të përhapura dhe në pak njësi të tjera, për një pjesë të vogël banorësh. Në njësinë Velçan ndërmjet popullatës, ndeshen thuajse të gjitha format e furnizimit vetjak me ujë të pijshëm të parashtrurara në anketim: burimi natyror, puse private, çezëm publike dhe lidhje të paligjshme.

PROBLEMATIKAT LIDHUR ME NGJYRËN E UJIT




Nga anketimi rezulton se, në pjesën më të madhe, banorët në Bashkinë Pogradec nuk ndeshin kurrë probleme me ngjyrën e ujit të pijshëm, ose vetëm rrallë. Megjithatë, një përqindje e vogël në njësitet Udenisht dhe Buçimas shprehen se këtë problem e ndeshin shpesh. Në disa njësi administrative ngjyra e ujit është ndonjëherë problem, kjo vihet re veçanërisht në njësine administrative Veliçan.




Gjendja shfaqet e përafërt gjithashtu për erën e keqe të ujit të pijshëm. Pjesa më e madhe e banorëve pohojnë se kjo nuk ndodh kurrë ose vetëm rrallë. Në njësitë administrative Propishtë Velçan dhe Buçimas, një pjesë e vogël e banorëve pohojnë, në të kundërt, se era e keqe e ujit të pijshëm është shpesh një problem.

MËNYRA E LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTUR




Përsa i perket menyres se largimit të ujerave të perdorur në bashkinë Pogradec veme re që me perjashtim të qendres se qytetit banorët e të cileve janë pergjigjur se këtë sherbim e marrin nga operatori i cili operon në zonen e qytetit, banorët e njesive administrative perreth janë pergjigjur në masen më të madhe se largimin e ujerave të perdorur e kryejne me sistemin e gropave septike ose me rrjedhje të lire. Kjo gje ndikon shumë në cilesine e



Banorët e anketuar shprehen në një masë të madhe aspak të kënaqur me shërbimin e largimit të ujërave të ndotur në zonën e tyre; kjo pakënaqësi mbizotëron në të gjithë Bashkinë Pogradec, megjithatë vërehet më pak në njësinë administrative Çerravë dhe Trebinjë, dhe në qytetin e Pogradecit asnjë banorë i anketuar nuk shprehet i pakënaqur. Në të kundërt, në të tre këto zona, një pjesë e konsiderueshme banorësh shprehen të kënaqur me shërbimin e largimit të ujërave të ndotur.

PROBLEMATIKAT LIDHUR ME UJIN E PIJSHËM DHE KANALIZIMET




Në Bashkinë Pogradec, në tërësi, problematikat në lidhje me ujin e pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotur ndeshen në masë të përafërt, sipas mendimit të të anketuarve. Përjashtim është tarifa e këtyre shërbimeve, niveli i së cilës konsiderohet i papërbalueshëm vetëm në qytetin e Pogradecit, nga një pjesë e ndjeshme e banorëve të anketuar. Gjithashtu, vihet re se banorët e anketuar në qytet, veçojnë kushtet e papërshtatshme higjienike ndër problemet kryesore me të cilat ata ndeshen.

6.5. Bashkia Durrës


Bashkia Durrës me qendër qytetin e Durrësit përbehet nga pesë njësi administrative: Durrës, Sukth, Ishëm, Rrashbull, Katundit të Ri, dhe Manëz, me popullsi gjithsej 289 595 banorë, sipas të dhënave të Regjistrat Civil. Njësia me distancë më të largët nga Durrësi është Ishmi me 30 km. Njësitë e tjera janë në largësi të papërfillshme nga qyteti i Durrësit.

Dendësia e popullsisë është shumë e lartë në zonën më urbane të Bashkisë, qytetin e Durrësit me rreth 2 900 banorë/m², ndërsa është shumë e ulët në njësitë e tjera, në nivelet 200 - 400 banorë/m². Njësia administrative Ishëm në veçanti ka shpërndarje të gjerë të banorëve dhe gjithashtu largësinë më të madhe nga shërbimet.




Sipas anketimit të qytetareve në qytetin e Durrësit shohim qarte se menyra kryesore e furnizimit me uje qendron ajo e furnizimit nga rrjeti qendror i furnizimit me uje. Njesite administrative si ajo e qendres se qytetit, katundi i ri si dhe njesia administrative sukth e perdorin këtë burim të furnizimit më uje në normat mbi 90%, në dallim nga njesite e mesiperme Ishmi dhe Manez shfaqin menyra të tjera të furnizimit më uje.

KËNAQSHMËRIA ME SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË




Përsa i perket kenaqshmerise me sherbimin e furnizizmit me uje ne bashkine Durres me perjashtim te qytetit dhe zones Katundi i ri te cilet shfaqen te kenaqur rreth 50% e popullsisë njesite e tjera vendore shfaqin një pakenaqesi të dukshme persa i perket ketij sherbimi. Sikurse tregohet dhe në harte pakenqasine më të lartë e shfaqin banorët e zones se Sukthit.




Perdorimi i depozitave jo-zyrtarisht tregon dhe nivelin e furnizimit më uje gjate dites për ato familje të cilat i perdorin duke qene se krijohet rezerva e mjaftueshme për ta perdorur atë gjate oreve kur nuk bëhet furnizimi nga rrjeti. Sipas hartes se mesiperme e cila tregon pikerisht nivelin e perdorimit të depozitave në njesit administrative shohim se pjesa më e madhe e të intervistuarëve janë shprehur se perdorin një depozite të rezervave ujore, ku 100% e banoreve të pyetur në zonen e Rreshbullit dhe Katundit të ri i perdorin depozitat në familjet e tyre.

MËNYRA ALTERNATIVE E FURNIZIMIT ME UJË




Për ata banorë të cilet janë shprehur gjate pjeses se pare të pytesorit që nuk janë të lidhur me sistemin e furnizimit me uje e siguruar nga ndermarrja shtetere ose private e cila operon ne Bashkine Durres më se shumti janë shprehur se puset private dhe burime të tjera natyrore janë menytrat që ata sigurojne furnizimin më uje në familjet e tyre. Gjithashtu ka nga ata të cilet janë pergjigjur se e blejne ujin të cilin konsumojne por nuk mungonin dhe nga ata të cilet pranonin që për mungese të një lidhje të ligjshme në sistemin e furnizimit më uje janë detyruar të kryejne një lidhje të paligjshme në këtë sistem.

PROBLEMATIKAT LIDHUR ME ERËN E KEQE TË UJIT




Përsa i perket problematikave lidhur më cilesine e ujit të pijshem që banorët e Bashkise Durrës marin janë ngritur disa indikatore për matjen e kesaj cilesi, një prej tyre është dhe problematika lidhur më eren e keqe të ujit që ata perdorin dhe sipas banoreve të intervistuar rastet kur ata e ndjejne këtë problem janë të rralla për të mos thene asnjehere. Në zonen e qytetit ka patur dhe nga ata banorë të cilet janë shprehur se e ndjejne gjithmone ere të keqe në ujin që ata perdorin. Katundi i ri paraqet situaten më të mire ndersa më problematiku paraqitet Rrashbulli, dhe Ishmi i ndjekur nga Sukthi.

PROBLEMATIKAT LIDHUR ME NGJYRËN E UJIT




Gjithashtu situata në lidhje me problematiken që paraqet uji më ngjyre pjesa më e madhe e banoreve në zonat rurale siç janë Rashbulli dhe Ishmi shprehen se shpesh u takon që të hasen më ujin më ngjyre që sipas tyre vjen si pasojë e amortizimit të rrjetit të vjetëruar dhe që i cili kërkon investim. Sikurse në rastin e pare zona e katundit të ri shfaq një tendence më të lehte në hasjen e kesaj problematike.

MËNYRA E LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTUR




Përsa i perket menyres se largimit të ujerave të ndotura urbane vihet re një nivel i ulët i largimit të ujerave të ndotura nga operatorët vendore ndërsa niveli i largimit të ujerave të ndotura më ane të teknologjise se gropave septike. Ky sistem gjithashtu vihet re dhe në njesine administrative Durrës ku supozohet që shtrirja e sistemit të largimit të ujerave të ndotur të jete i shtrire në gjithë qytetin.

KËNAQSHMËRIA ME SHËRBIMIN E LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTUR



Lidhur me kënaqshmerine me sherbimin e largimit te ujerave te ndotura urbane shumica e banoreve jane shprehur te pakenaqur me ketë sherbim. Ku banorët e njesise administrative Sukth dhe Maminas kanë pakenqesine më të lartë. Sipas banoreve ky sherbim është shumë i dobet në Bashkine Durres duke reflektuar keshtu dhe në reagimin e banoreve lidhur me këtë sherbim.

PROBLEMATIKAT LIDHUR ME UJIN E PIJSHËM DHE KANALIZIMET



Përsa i perket problematikave lidhur me ujin e pijshem dhe kanalizimet, banorët janë shprehur se problematikat kryesore që gjithashtu janë në nivelet më të larta janë mungesa e aksesit në sistemin e ujit të pijshem, kushtet e papërshtatshme higjienik si dhe mungesa e aksesit në sistemin e kanalizimeve.

6. Masa dhe rekomandime

Agregimi ose faktori i bashkimit

Bazuar në rezultatet e pergjigjeve të personave të pytur në kuader të ketij projekti Instituti i Kërkimeve Urbane në bashkepunim me organizatat e tjera pjesemarrese të ketij rrjeti organizatash ka pergatitur një set rekomandimesh të cilat do të ndihmojne autoritetet perkatese për të permiresuar cilesine e sherbimit dhe rrjedhimisht të rritet dhe aksesit i banoreve në sistemin e furnizimit me uje dhe atë të largimit të ujerave të ndotur urban.

1. Kur të merren vendimet për agregimin ose bashkimin e një ose më shume segmenteve apo njësive në një instrument të përbashkët administrimi, disa konsiderata të përgjithshme duhet të aplikohen nga vendimmarrësit:
 - a. Vendimi për këtë akt duhet të merret duke pasur parasysh kushtet në të cilat ushtrohet funksioni i shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, të tilla si: (i)

mbrojtja e shëndetit dhe siguria e publikut; (ii) ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit; (iii) llogaridhënia, transparenca, pjesmarrja dhe barazia në vendimmarrje; (iv) eficientia dhe efektiviteti i kostos; (v) si dhe interesi i përgjithshëm i komunitetit.

- b. Agregimi nuk duhet të bëhet për hir të agregimit, por duhet të bazohet në konsiderata të qarta të përfitimit në kosto, si dhe në përcaktimin e qartë e të saktë të asaj që humbet dhe të asaj që fitohet nga ky proces.
2. Përpara se të merren vendime në lidhje me agregimin si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor, njësitë përgjegjëse qeverisëse duhet që të krijojnë një njësi administrative të vecantë përgjegjëse për ristrukturimin apo agregimin. Kjo njësi do të jetë përgjegjëse për të përgatitur monitoruar procesin deri në përfundimin e veprimit.
3. Ne fillim, pavarësisht nga niveli i agregimit, (i pjeshem apo i plote, i ofrimit me shumice apo me pakice të shërbimit) ai duhet të mbështetet me incentiva financiare kundrejt detyriemve të qarta që sjelin përfitimet e llogjitura. Njësia qeverisëse duhet të adoptojë një proces agregimi që zhvillohet hap pas hapi të cilët përfshijnë të paktën hapat që vijojnë:
 - a. Shtrirja e zonës së shërbimit të furnizmit me uje dhe kanalizimeve të kompanive/ndërmarrjeve që të përputhen me juridiksionin territorial dhe administrativ të njësive të reja vendore;
 - b. Bashkimi i shërbimit të furnizmit me uje me shërbimin e kanalizimeve për të gjitha ato raste kur këto janë të ndara nën administrimin e ndërmarrjeve/kompanive të ndryshme;
 - c. Agregimin, me nje qasje rast pas rasti, të segmenteve të shërbimit, sic mund të jenë prodhimi, trajtimi dhe transmetimi i ujit dhe trajtimi i ujrave të zeza.

Shpërndarja e investimeve kapitale

Ekspertet rekomandojnë së shpërndarja e investimeve kapitale duhet të bazohet në një sistem me dy blloqe financimi:

1. Investime kapitale sipas nje skeme e cila bazohet në performancën e kompanive që do të ndihmojë në përmirësimin e qendrueshmërisë operacionale të kompanive/ndërmarrjeve dhe uljen e subvencionit të QQ, dhe
2. Investime kapitale të bazuara në objektivat strategjike të vendit (sic mund të jenë shprehur nga strategjinë apo në masterplanin e zhvillimit të sektorit)


Blloku I parë për investimet sipas performancës përbëhet nga të ardhura nga buxheti I shtetit që përdoret aktualisht për financimin e subvencionit dhe granteve konkurruese të fondit të rajoneve, si dhe nga fondet e veta të bashkive.

Ndarja ose burimi I dytë përbëhet nga buxheti I shtetit, I mbështetur nga financimet e donatorëve, për arritjen e objektivave strategjike dhe masterplanin e zhvillimit të sektorit.


7. Aneksi 1: Rezultatet e anketimit qytetar për gjendjen aktuale të furnizimit më ujë dhe kanalizimeve në qytetet në studim.

7.1. Rezultatet Elbasan

Furnizimi me ujë të pijshëm




Kur u pyeten në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm, 6% e të intervistuarve janë përgjigjur se furnizohen nga ndërmarrje shtetërore, 91% nga ndërmarrja e B/K, ndërsa 3% nga vetë komuna apo bashkia.




Lidhur me faktin se sa të kënaqur janë ata me furnizimin me ujë të pijshëm, 2% e të intervistuarve u shprehën se janë shumë të kënaqur, 16% e tyre të kënaqur, 62% deri diku të kënaqur, 19% të tjerë shprehen aspak të kënaqur dhe pjesa tjetër 1% janë përgjigjur nuk e di.

1/c A përdorni depozitë uji në shtëpinë tuaj?




Lidhur me pyetjen se a përdorin depozita në shtëpitë e tyre 67 % janë përgjigjur po, ndërsa 33% të tjerë shprehen se nuk përdorin depozita uji në shtëpitë e tyre.

1/d Gjatë 6 muajve të fundit sa orë në ditë jeni furnizuar me ujë?




Lidhur me pyetjen gjatë 6 muajve të fundit sa orë në ditë jeni furnizuar me ujë 32% janë përgjigjur 1-4 orë në ditë, 62 % pesë-dhjetë orë në ditë, 2% njëmbëdhjetë ose më shumë orë në ditë, 4% furnizim 24 orë pa ndërprerje.

1/e A përdorni pompë uji në familjen tuaj për furnizimin me ujë?



Lidhur me pyetjen a përdorni pompë uji në familje për furnizimin me ujë 42% janë përgjigjur po dhe 58% jo.



Lidhur me pyetjen a keni matës uji 88% e të intervistuarëve janë përgjigjur po, ndërsa 12% shprehen jo.



Në rastin kur banorët janë pyetur a paguajnë tarifë për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 93% e tyre janë përgjigjur po, 7% jo.



Banorët u pyetën se nëse e paguanin tarifën, a mendonin se kjo është e përballueshme, 36% e tyre mendojnë se është e përballueshme, 22% nuk përbën problem, 37% e papërballueshme, 4% nuk mund ta paguajnë, ndërsa 1% shprehen nuk e di.




Banorët që nuk e paguanin u pyetën a do t'a paguajnë tarifën nëse shërbimi me ujë dhe kanalizime do të përmirësohej, 100% e tyre u përgjigjën po.

Lidhur me cilësinë e ujit të intervistuarit janë pyetur për disa nga problematikat që ata mund të kenë gjatë furnizimit me ujë. Disa nga problemet kryesore që parashtrihen nga pyetësi janë: erë e keqe e ujit, shije e keqe e ujit, ujë me ngjyrë, presion i ulët i ujit, temperaturë e ulët (ngjirje).




Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me erën e keqe të ujit, 2% e të intervistuarve janë përgjigjur shpesh, 12% ndonjëherë, 19% e të intervistuarve kanë thënë rrallë, 62% kanë thënë kurrë, ndërsa pjesa tjetër e të intervistuarve prej 10% shprehen nuk e di.

3/b Shije e keqe e ujit




Banorët u pyetën në lidhje me shijen e keqe të ujit, 6 % e tyre shpesh herë, 15 % ndonjëherë, 32 % e të intervistuarve kanë thënë rrallë, 45% kurrë, ndërsa pjesa tjetër e të intervistuarve 7% thonë se nuk e dinë.

3/d Ujë me ngjyrë




Në rastin kur banorët janë pyetur në lidhje me ujin me ngjyrë të turbullt, 2% e tyre shprehen shpesh herë, 11% ndonjëherë, 18% e të intervistuarve kanë thënë rrallë, 59% kurrë, ndërsa pjesa tjetër e të intervistuarve 10% shprehen nuk e di.

3/c Presion i ulët i ujit



Kur banorët janë pyetur në lidhje me presionin e ujit, 8% e të intervistuarve janë përgjigjur gjithnjë, 25% e tyre shpesh, 26% ndonjëherë, 30% thonë rrallë, 8% kurrë, 3% të tjerë shprehen nuk e di.


3/e Temperatura e ulet (ngrirje)



Përsa i përket pyetjes a keni patur temperatura te ulëta te ujit deri në ngrirje që shoqërohen me carje të tubacioneve, 1% janë përgjigjur gjithnjë, 9% ndonjëherë, 82% janë përgjigjur rrallë, 7% kurrë, 1% nuk e di.

3.2 Shërbimi i largimit të ujërave të zeza

4/a Largimi i ujërave te ndotur realizohet nëpërmjet




Për pyetjen se si realizohet largimi i ujërave të ndotur qytetarët janë përgjigjur se ky shërbim në masën 10% realizohet nga operatori shtetëror sh.a., ndërsa për 90% të të anketuarve realizohet nga ndërmarrja B/K.

4/b Sa të kënaqur janë qytetarët me largimin e ujërave të ndotur?



Për pyetjen se sa të kënaqur jeni me largimin e ujërave të zeza 8% janë përgjigjur shumë të kënaqur, 43% të kënaqur, 42% deri diku të kënaqur, ndërsa 7% shprehen aspak të kënaqur.

5/a Sipas opinionit tuaj, cilat janë tre problemet më serioze me te cilat ndeshet sot qyteti/fshati apo zona juaj ne fushën e shërbimit me ujë/kanalizime?




Gjithashtu banorët janë pyetur se cilat janë sipas tyre tre problemet më serioze me të cilat ndeshet sot zona në fushën e shërbimit me ujë dhe kanalizime.

Rreth 1% e tyre mendojnë se problemi më i madh është që nuk kanë lidhje uji, 31% mendojnë se uji është i pamjaftueshëm, 24% mendojnë se cilësia e ujit është e papërshtatshme, 30% mendojnë se kushte higjeno-sanitare janë të papërshtatshme, 14% që tarifa e ujit dhe e kanalizimeve është e papërbalueshme. Rreth pyetjes tjetër problem specifik janë renditur këto probleme: Tubacionet e ujit të pijshëm janë të amortizuara; Tubacionet e ujit dhe të ujrave të zeza nuk mirëmbahen; kanalizimet e ujrave të zeza janë shumë të amortizuara.


Komuna Gjerqjan

1/a Nga cili furnizues e merrni ujin?



Në lidhje me pyetjen nga cili furnizues e merrni ujin 40% janë përgjigjur ndërmarrje shtetërore sh.a dhe 60% tek rubrika tjetër specifik (puse, burime; referoju rubrikes 2- Nëse nuk furnizoheni nga sistemi, nga furnizoheni?)

1/b Sa i kënaqur jeni me furnizimin me ujë?




Në lidhje me pyetjen sa i kënaqur jeni me furnizimin me ujë 20% janë përgjigjur shumë të kënaqur, 15% të kënaqur, 45% deri diku të kënaqur dhe 20% aspak të kënaqur.

1/c A përdorni depozitë uji në shtëpinë tuaj?




Lidhur me pyetjen se a përdorin depozita në shtëpitë e tyre 30 % janë përgjigjur po, ndërsa 70% të tjerë janë shprehur jo.

1/d Gjatë 6 muajve të fundit sa orë në ditë jeni furnizuar me ujë




Lidhur me pyetjen gjatë 6 muajve të fundit sa orë në ditë jeni furnizuar me ujë 15% përgjigjen një –katër orë në ditë, 30% thonë njëmbëdhjetë ose më shumë orë në ditë, 55% furnizim 24 orë pa ndërprerje.

1/e A përdorni pompë uji në familjen tuaj për furnizimin me ujë?




Lidhur me pyetjen se a përdorin pompa në shtëpitë e tyre 65% janë përgjigjur po, 35% jo.

1/f Keni matës uji?




Kur u pyeten a keni matës uji 40 % e të anketuarve u përgjigjën po dhe 60% të tjerë jo.

1/g A paguani tarifë për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve?




Në lidhje me pagesën e tarifës së ujit dhe kanalizimeve 35% e të anketuarve u përgjigjën po dhe 65% jo.

1/gj Nëse po, a mendoni se tarifa është e papërballueshme për nivelin tuaj ekonomik?




Për ata të cilët e paguanin tarifën u shtrua pyetja në është apo jo e përballueshme dhe 34% u përgjigjën e përballueshme, 22% e papërballueshme, 22% nuk mund ta paguajnë, 22% nuk e dinë (këtu kemi parasysh të rinjtë e intervistuar).

1/h Nëse jo, a do të paguanit tarifë nëse shërbim me ujë e kanalizime përmirësohej?



Për ata të cilët nuk e paguanin u pyetën nëse shërbimi do të përmirësohej a do t'a paguanit 100% e tyre u përgjigjën po.


2- Nëse nuk furnizoheni nga sistemi, nga furnizoheni?




Në lidhje me pyetjen se nëse nuk furnizoheni nga sistemi nga furnizoheni 25% u përgjigjën se furnizohen nga burime natyrore dhe 75% përmes puseve private.

Përsa i takon cilësisë së ujit me të cilin jeni furnizuar gjatë 12 muajve të shkuar, a keni pasur ndonjë problem me elementët më poshtë, dhe nëse po, a mund të na tregonit sa shpesh shfaqët ky problem?


3/a Erë e keqe e ujit




Në lidhje me problemin e erës së keqe 5% e të anketuarve janë përgjigjur shpesh, 15% ndonjëherë, rrallë janë shprehur rreth 30% e të anketuarve ndërsa 50% të jerë janë përgjigjur kurrë.



Mbi shijen e keqe të ujit 5% e të anketuarve janë përgjigjur shpesh, 25% janë shprehur ndonjëherë, rrallë janë përgjigjur rreth 30% e të anketuarve, 35% janë shprehur kurrë, ndërsa 5% janë përgjigjur nuk e di.




Lidhur me presioni e ulët të ujit 10% e të anketuarve janë përgjigjur gjithnjë, 20% shpesh, 15% shprehen ndonjëherë, rrallë janë përgjigjur rreth 25% e të anketuarve, ndërsa kurrë janë shprehur 30% e tyre.




Kur janë pyetur mbi ujin me ngjyrë ose të turbullt 10% e të anketuarve janë përgjigjur ndonjëherë, rrallë janë shprehur rreth 30% e të anketuarve, ndërsa 60% janë shprehur kurrë.

3/e Temperatura e ulet (ngrirje)




Në lidhje me pyetjen a ka patur ujë me temperaturë të ulët deri në ngrirje 5% e të anketuarve janë përgjigjur gjithnjë, 25% janë shprehur shpesh, 10% ndonjëherë, rrallë janë përgjigjur rreth 30% e të anketuarve, 25% janë shprehur kurrë, ndërsa 5% e tyre janë përgjigjur nuk e di.

4/a Largimi i ujërave të ndotur realizohet nëpërmjet




Në lidhje me pyetjen si bëhet largimi i ujrave të ndotur 65% janë përgjigjur me gropa septike dhe 35% me rrjedhje të lirë në natyrë.

4/b Sa të kënaqur janë qytetarët me largimin e ujërave të ndotur?



Sa të kënaqur janë qytetarët me largimin e ujërave të ndotur 5% u përgjigjën shumë të kënaqur, 30% deri diku të kënaqur, 65% aspak të kënaqur.

5/a Sipas opinionit tuaj, cilat janë tre problemet më serioze me te cilat ndeshet sot qyteti/fshati apo zona juaj ne fushën e shërbimit me ujë/kanalizime?




Sipas opinionit tuaj, cilat janë tre problemet më serioze me të cilat ndeshet sot qyteti/fshati apo zona juaj në fushën e shërbimit me ujë/kanalizime?

Rreth 5% e të intervistuarve janë përgjigjur nuk ka (lidhje) akses uji, 30% janë shprehur se nuk ka lidhje (akses) me kanalizimet, 7% uji është i pamjaftueshem, 29% cilësia e ujit është e papërshtatshme, 22% kushtet higjeno-sanitare janë të papërshtatshme dhe 7% të tjerë shprehen se tarifa e ujësjellës kanalizimeve është e papërbalueshme.


Komuna Paper

1/a Nga cili furnizues e merrni ujin?




Kur u pyetën në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm, 25% e të intervistuarve janë përgjigjur se furnizohen nga ndërmarrje shtetërore, 75% të tjerë janë përgjigjur se furnizimin me ujë e kanë me pus.

1/b Sa i kënaqur me furnizimin me ujë?




Lidhur me faktin se sa te kënaqur janë ata me furnizimin me ujë të pijshëm, 10% e të intervistuarve u shprehën se janë shumë te kënaqur, 20% e tyre të kënaqur, 50% deri diku të kënaqur, 20% aspak te kënaqur.

1/c A përdorni depozitë uji në shtëpinë tuaj?




Lidhur me pyetjen se a përdorin depozita në shtëpitë e tyre 80% e të intervistuarve janë përgjigjur po, ndërsa 20% jo.

1/d Gjatë 6 muajve të fundit sa orë në ditë jeni furnizuar me ujë?




Ndërsa pyetjes se gjatë 6 muajve të fundit sa orë në ditë jeni furnizuar me ujë ju përgjigjën: 20% 1-4 orë në ditë, 10% pesë-dhjetë orë në ditë, 15% njëmbëdhjetë ose më shumë orë në ditë dhe 55% furnizim 24 orë në ditë (pus).

1/e A përdorni pompë uji në familjen tuaj për furnizimin me ujë?




Lidhur me pyetjen se a përdorin pompa uji në shtëpitë e tyre 60% e të intervistuarve janë përgjigjur po, 40% të tjerë shprehen jo.

1/f Keni matës uji?




Lidhur me pyetjen a keni matës uji 15% e të intervistuarve janë përgjigjur po, ndërsa 85% jo.

1/g A paguani tarifë për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve?




Në rastin kur Banorët janë pyetur a paguajnë tarifë për shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve 30% e tyre janë përgjigjur po, 70% të tjerë janë shprehur jo (furnizohen me pus).

1/gj Nëse po, a mendoni se tarifa është e përballueshme për nivelin tuaj ekonomik?




Banorët u pyeten se nëse e paguani tarifën, a mendoni se kjo është e përballueshme, 71% e tyre mendojnë se është e përballueshme, 29% e papërballueshme.

1/h Nëse jo, a do të paguanit tarifë nëse shërbim me ujë e kanalizime përmirësohej?



Banorët u pyeten se nese jo, a do t'a paguajë tarifën nëse shërbimi me ujë dhe kanalizime do të përmirësohej, 100% e atyre që nuk paguanin u përgjigjën po.


2- Nëse nuk furnizoheni nga sistemi, nga furnizoheni?



Banorët që nuk furnizoheshin nga sistemi u pyetën për burimet e tjera të furnizimit me ujë, në 13% të rasteve shprehen se furnizoheshin nga burime natyrore, 87% furnizoheshin nga puse private.


Lidhur me cilësinë e ujit të intervistuarit janë pyetur për disa nga problematikat që ata mund të kenë gjatë furnizimit me ujë. Disa nga problemet kryesore që parashtrihen nga pyetësi janë: erë e keqe e ujit, shije e keqe e ujit, ujë me ngjyrë, presion i ulët i ujit, temperaturë e ulët (ngirije).

3/a Erë e keqe e ujit




Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me erën e keqe të ujit, 15% e tyre janë përgjigjur se ka ndodhur rrallë, 85% e të intervistuarve janë shprehur kurrë.

3/b Shije e keqe e ujit




Banorët u pyetën në lidhje me shijen e keqe të ujit, 10% e të intervistuarve janë shprehur shpesh herë, 10% të tjerë janë përgjigjur ndonjëherë, rrallë janë përgjigjur rreth 45% të të anketuarve ndërsa 35% janë shprehur se kurrë shija e ujit nuk ka bërë një problem.


3/c Presion i ulët i ujit




Kur banorët janë pyetur në lidhje me presionin e ujit, 10% e tyre janë përgjigjur shpesh herë, 40% janë shprehur ndonjëherë, 15% rrallë, ndërsa 35% janë përgjigjur kurrë.



Në rastin kur banorët janë pyetur në lidhje me ujin me ngjyrë, 15% e tyre janë shprehur rrallë, 40% kanë thënë kurrë dhe 45% të tjerë janë shprehur nuk e di.




Përsa i përket pyetjes a keni patur temperatura të ulëta të ujit deri në ngrirje, 5% e të intervistuarve janë përgjigjur shpesh, 30% e tyre shprehen ndonjëherë, rrallë janë përgjigjur rreth 10% e të anketuarve, ndërsa 55% të tjerë janë përgjigjur kurrë.




Për pyetjen se si realizohet largimi i ujërave të ndotur qytetarët janë përgjigjur se ky shërbim në masën 5% të intervistuarit janë shprehur se realizohej nga operatori shtetëror sh.a., 90% me gropa septike, 5% me rrjedhje të lirë.

4/b Sa janë të kënaqur janë qytetarët me largimin e ujërave te ndotur?



Për pyetjen se sa të kënaqur jeni me largimin e ujërave të zeza, 50% u përgjigjën se janë të kënaqur me këtë shërbim, 35% e tyre u përgjigjën se janë deri diku të kënaqur, 15% janë shprehur nuk e di.

5/a Sipas opinionit tuaj, cilat janë tre problemet më serioze me te cilat ndeshet sot qyteti/fshati apo zona juaj ne fushën e shërbimit me ujë/kanalizime?




Gjithashtu banorët janë pyetur se cilat janë sipas tyre tre problemet me serioze me të cilat ndeshet sot zona në fushën e shërbimit me ujë dhe kanalizime.

Rreth 18 % e tyre mendojnë se problemi më i madh është që nuk kanë lidhje uji, 32% që nuk kanë lidhje me sistemin e kanalizimeve, 8% mendojnë që uji është i pamjaftueshem, 13% që cilësia e ujit është e papershtatshme, 26% mendojnë që kushtet higjeno-sanitare janë të papërshtatshme, 3% që tarifa e ujit dhe e kanalizimeve është e papërbalueshme dhe tek versioni të tjera specifiko janë percaktuar dy probleme: Tubacionet e ujit të pijshëm janë të amortizuara; Nuk ka kanalizime të ujërave të zeza.


Komuna Bradashesh

1/a Nga cili furnizues e merrni ujin?




Kur u pyeten në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm, 60% e të intervistuarve janë përgjigjur se furnizohen nga ndërmarrje shtetërore, 40% e tyre janë përgjigjur se furnizimin me ujë e kanë me pus ose burim.

1/b Sa i kënaqur jeni me furnizimin me ujë?




Nga ana tjetër me faktin se sa të kënaqur janë ata me furnizimin me ujë të pijshëm, 10% e të intervistuarve u shprehën se janë shumë të kënaqur, 53% e tyre të kënaqur, 26% deri diku të kënaqur, ndërsa 11% u shprehën aspak të kënaqur.

1/c A përdorni depozitë uji në shtëpinë tuaj?




Lidhur me pyetjen se a përdorin depozita uji në shtëpite e tyre 60 % janë përgjigjur po, ndërsa rreth 40% të tjerë janë shprehur jo.

1/d Gjatë 6 muajve të fundit sa orë ne ditë jeni furnizuar me ujë?




Ndërsa pyetjes se gjatë 6 muajve të fundit sa orë në ditë jeni furnizuar me ujë ju përgjigjën: 20% 1-4 orë në ditë, 10% pesë-dhjetë ore në ditë, 15% njëmbëdhjetë ose më shumë ore në ditë dhe 55% furnizim 24 orë në ditë (pus).

1/e A përdorni pompë uji në familjen tuaj për furnizimin me ujë?




Lidhur me pyetjen se a përdorin pompa uji në shtëpitë e tyre 35% e të intervistuarve janë përgjigjur po, ndërsa 65% të tjerë janë shprehur jo.

1/f Keni matës uji?




Lidhur me pyetjen a keni mates uji 65% e të intervistuarve janë përgjigjur po, ndërsa 35% jo.

1/g A paguani tarifë për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve?




Në rastin kur banorët janë pyetur a paguajnë tarifë për shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve 55% e tyre janë përgjigjur po, 40% jo dhe 5% janë shprehur nuk e di.

1/gj Nëse po, a mendoni se tarifa është e përballueshme për nivelin tuaj ekonomik?




Banorët u pyeten se nese e paguani tarifen, a mendoni se kjo është e përballueshme, 17% mendojnë se është e përballueshme, 42% mendojnë se nuk përbën problem, 33% mendojnë se është e papërballueshme dhe 8% janë shprehur nuk e di.

1/h Nëse jo, a do të paguanit tarifë nëse shërbim me ujë e kanalizime do të përmirësohej?



Banorët u pyeten se nese jo, a do ta paguajnë tarifen nëse shërbimi me ujë dhe kanalizime do të përmirësohej, 87% e tyre u përgjigjën po, 13% nuk e di.

2- Nëse nuk furnizoheni nga sistemi, nga furnizoheni?




- 1- Burim natyror
- 2- Puse private
- 3- Çesma publike
- 4- Lidhje te paligjshme
- 5- Te tjera burime
- 6- Nuk kam ujë (e blejmë)
- 8- Nuk e di
- 9- Pa përgjigje

Banorët që nuk furnizoheshin nga sistemi u pyetën për burimet e tjera të furnizimit me ujë, 100% furnizoheshin nga burime natyrore.

Lidhur me cilësinë e ujit të intervistuarit janë pyetur për disa nga problematikat që ata mund të kenë gjatë furnizimit me ujë. Disa nga problemet kryesore që parashtrihen nga pyetësi janë: erë e keqe e ujit, shije e keqe e ujit, ujë me ngjyr, presion i ulët i ujit, temperaturë e ulët (ngjirje).


3/a Erë e keqe e ujit



- 1- Gjithnjë
- 2- Shpesh
- 3- Ndonjëherë
- 4- Rrallë
- 5- Kurrë
- 8- Nuk e di
- 9- Pa përgjigje


Në rastin kur banorët janë pyetur në lidhje me erën e keqe të ujit, 5% e tyre janë përgjigjur ndonjëherë, rrallë janë përgjigjur rreth 5% të tjerë, 85% janë shprehur kurrë, ndërs 5% të tjerë janë shprehur nuk e di.

3/b Shije e keqe e ujit




- 1- Gjithnjë
- 2- Shpesh
- 3- Ndonjëherë
- 4- Rrallë
- 5- Kurrë
- 8- Nuk e di
- 9- Pa përgjigje


Banorët u pyetën në lidhje me shijen e keqe të ujit, 10% e tyre u shprehën ndonjëherë, 25% e të intervistuarve janë shprehur rrallë, kurrë janë përgjigjur rreth 60% e të anketuarve, ndërsa 5% janë shprehur nuk e di.



Kur banorët janë pyetur në lidhje me presionin e ujit, 20% e të intervistuarve janë përgjigjur se shpesh kanë ujë me presion të ulët, 5% janë përgjigjur ndonjëherë, rrallë janë shprehur rreth 30% e të anketuarve, rreth 40% e të anketuarve janë shprehur se kurrë nuk kanë patur probleme me presionin e ulët dhe 5% janë përgjigjur nuk e di.




Në rastin kur banorët janë pyetur në lidhje me ujin me ngjyrë, 10% e tyre janë përgjigjur ndonjëherë, rrallë janë shprehur 20% e të anketuarve, 65% janë shprehur se kurrë nuk kanë patur problem me ngjyrën e ujit dhe 5% janë përgjigjur nuk e di.




Në lidhje me temperaturën e ulët të ujit 5% e të anketuarve janë shprehur se shpesh temperatura e ujit përbën një problem, rrallë janë përgjigjur rreth 10% e të anketuarve, 80% janë shprehur kurrë dhe 5% të tjerë janë shprehur nuk e di.

4/a Largimi i ujrave të ndotur realizohet nëpërmjet




Për pyetjen se si realizohet largimi i ujërave të ndotur janë përgjigjur se ky shërbim në masën 15% realizohet nga operatori shtetëror sh.a., 75% me gropa septike, 10% me rrjedhje të lirë.

4/b Sa të kënaqur janë qytetaret me largimin e ujërave të ndotur?



Për pyetjen se sa të kënaqur jeni me largimin e ujërave të zeza, pjesa më e madhe prej 50% u përgjigjën se janë deri diku të kënaqur me këtë shërbim, 15% janë shprehur se janë shumë të kënaqur, 10% të kënaqur dhe pjesa tjetër të cilat përbëjnë 25% të intervistuarve kanë thënë nuk janë aspak të kënaqur.


5/a Sipas opinionit tuaj, cilat janë tre problemet më serioze me te cilat ndeshet sot qyteti/fshati apo zona juaj ne fushën e shërbimit me ujë/kanalizime?




Gjithashtu banorët janë pyetur se cilat janë sipas tyre tre problemet më serioze me te cilat ndeshet sot zona ne fushen e shërbimit me ujë dhe kanalizime.

Rreth 14% e tyre mendojnë se problemi me i madh është që nuk kanë lidhje uji, 31% që nuk kanë lidhje me sistemin e kanalizimeve, 16 % mendojnë që uji është i pamjaftueshem, 6% që cilësia e ujit është e papershtatshme, 27% mendojnë që kushtet higjeno-sanitare janë të papershtatshme, ndërsa 6% që tarifa e ujit dhe e kanalizimeve është e paperballueshme.

Komuna Labinot-Fushë




Kur u pyeten në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm, 50% e të intervistuarve janë përgjigjur se funizohen nga ndermarrje shtetere, 35% nga vete komuna apo bashkia dhe 15% tjetër (pus & burim).




Lidhur me faktin se sa te kënaqur janë ata me furnizimin me ujë të pijshëm, 10% e të intervistuarve u shprehën se janë shumë te kënaqur,45% e tyre te kanaqur, 35% deri diku te kënaqur ,10% aspak te kënaqur.

1/c A përdorni depozitë uji në shtëpinë tuaj?




Lidhur me pyetjen se a perdorin depozita uji në shtëpitë e tyre 40% e të intervistuarve janë përgjigjur po, ndërsa 60% të tjerë janë shprehur jo.

1/d Gjatë 6 muajve të fundit sa orë në ditë jeni furnizuar me ujë?




Lidhur me pyetjen gjatë 6 muajve të fundit sa ore në ditë jeni furnizuar me ujë 10% janë pergjigjur 1-4 ore në ditë, 25 % pesë-dhjetë orë ne ditë, 10% njëmbëdhjetë ose më shumë orë në ditë, 55% furnizim 24 orë pa ndërprerje.


1/e A përdorni pompë uji në familjen tuaj për furnizimin me ujë?



Lidhur me pyetjen a perdorni pompe uji ne familje per furnizimin me ujë 40% janë pergjigjur po dhe 60% jo.



Lidhur me pyetjen a keni matës uji 10% e të intervistuarve janë përgjigjur po, 90% jo.




Në rastin kur banorët janë pyetur a paguajn tarifë për shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve 70% e tyre janë përgjigjur po, ndërsa 30% të tjerë shprehen jo.




Banorët u pyeten se nëse e paguani tarifen, a mendoni se kjo është e përballueshme, 55% e tyre mendojnë se është e përballueshme, 20% e papërballueshme, 5% shprehen nuk e di, ndërsa 20% janë shprehur pa përgjigje.

1/h Nëse jo, a do të paguanit tarifë nëse shërbim me ujë e kanalizime do të përmirësohej?



Banorët që nuk e paguanin u pyetën a do të paguajn tarifën nëse shërbimi me ujë dhe kanalizime do të përmirësohej, 67% e tyre u përgjigjën po dhe 33% u shprehën pa përgjigje.


2- Nëse nuk furnizoheni nga sistemi nga furnizoheni?




Lidhur me pyetjen nëse nuk furnizoheni nga sistemi nga furnizoheni 75% e të intervistuarve janë përgjigjur nga burime natyrore dhe 25% nga çezma publike.

Lidhur me cilësinë e ujit të intervistuarit janë pyetur për disa nga problematikat që ata mund të kenë gjatë furnizimit me ujë. Disa nga problemet kryesore që parashtrohen nga pyetësi janë: erë e keqe e ujit, shije e keqe e ujit, ujë me ngjyrë, presion i ulët i ujit, temperaturë e ulët (ngjirje).


3/a Erë e keqe e ujit




Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me erën e keqe të ujit, 5% e të intervistuarve janë përgjigjur shpesh, 5% të tjerë shprehen ndonjëherë, rrallë janë përgjigjur rreth 15% e të intervistuarve 70% janë shprehur kurrë, ndërsa 5% të tjerë shprehen nuk e di.



Banorët u pyetën në lidhje me shijen e keqe të ujit, rreth 5% e tyre shprehen shpesh shija e keqe e ujit përbën një problem, 5% të tjerë janë përgjigjur ndonjëherë, rrallë janë shprehur rreth 15% e të intervistuarve, 70% e tyre janë përgjigjur se shija e ujit nuk ka përbërë kurrë një problem, ndërsa pjesa tjetër e të intervistuarve prej 5% shprehen nuk e di.




Kur banorët janë pyetur në lidhje me presionin e ujit 10% e të intervistuarve janë përgjigjur gjithnjë, 10% të tjerë shprehen shpesh, ndonjëherë janë përgjigjur rreth 35% e të intervistuarve, 15% shprehen rrallë, 15% kurrë, ndërsa 15% të tjerë shprehen nuk e di.



Në rastin kur banorët janë pyetur në lidhje me ujin me ngjyrë të turbullt, 5% e tyre janë shprehur shpesh uji i turbullt është një problem, 20% janë përgjigjur ndonjëherë, 15% e të intervistuarve janë shprehur rrallë, 45% kurrë, ndërsa pjesa tjetër e të intervistuarve prej 15% janë përgjigjur nuk e di.


3/e Temperatura e ulet (ngrirje)



Përsa i përket pyetjes a keni patur temperatura të ulëta të ujit deri në ngrirje 10% e të anketuarve janë përgjigjur shpesh, 10% të tjerë janë shprehur ndonjëherë, 70% e të anketuarve janë shprehur se nuk kanë patur kurrë problem me temperaturën e ulët të ujit, ndërsa 10% të tjerë janë përgjigjur nuk e di.


Shërbimi i largimit të ujërave të zeza

4/a Largimi i ujërave të ndotur realizohet nëpërmjet




Për pyetjen se si realizohet largimi i ujërave të ndotur qytetarët janë përgjigjur se ky shërbim në masen 65% realizohet me gropa septike, 35% të tjerë janë shprehur se realizohet me rrjedhje te lire

4/b Sa të kënaqur janë qytetarët me largimin e ujërave të ndotur?




Për pyetjen se sa të kënaqur jeni me largimin e ujërave të zeza, 5% janë përgjigjur shumë të kënaqur, 30% të kënaqur, 35% deri diku të kënaqur, ndërsa 30% u përgjigjën se nuk janë fare të kënaqur me këtë shërbim.



Gjithashtu banorët janë pyetur se cilat janë sipas tyre tre problemet më serioze me te cilat ndeshet sot zona ne fushen e sherbimit me ujë dhe kanalizime.

Rreth 6% e tyre mendojnë se problemi më i madh është që nuk kanë lidhje uji, 37% mendojnë se nuk ka lidhje (akses) me kanalizimet, 13% mendojnë se uji është i pamjaftueshem, 19% mendojnë se cilësia e ujit është e papershtatshme, 21% mendojnë e kushtet higjeno-sanitare janë të papershtatshme, 4% që tarifa e ujit dhe e kanalizimeve është e paperballueshme. Rreth pyetjes tjetër problem specifiko janë renditur keto probleme: Tubacionet e ujit të pijshëm janë të amortizuara; Nuk ka kanalizime të ujërave të zeza.

Komuna Shushicë




Kur u pyeten në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm, 100% e të intervistuarve janë përgjigjur se funizohen nga ndërmarrje shtetërore sh.a.

1/b Sa i kënaqur me furnizimin me ujë?




Lidhur me faktin se sa të kënaqur janë ata me furnizimin me ujë të pijshëm, 15% e të intervistuarve u shprehën se janë shumë të kënaqur, 35% e tyre janë të kënaqur, ndërsa 50% të tjerë shprehën aspak të kënaqur.

1/c A përdorni depozitë uji në shtëpinë tuaj?




Lidhur me pyetjen se a përdorin depozita në shtëpitë e tyre 30% janë përgjigjur po, ndërsa 70% të tjerë shprehën jo.

1/d Gjatë 6 muajve të fundit sa orë në ditë jeni furnizuar me ujë?




Lidhur me pyetjen gjatë 6 muajve të fundit sa orë në ditë jeni furnizuar me ujë 35% janë përgjigjur 1-4 orë në ditë, 20% pesë-dhjetë orë në ditë, 40% njëmbëdhjetë ose më shumë orë në ditë, 5% furnizim 24 orë pa ndërprerje.

1/e A përdorni pompë uji në familjen tuaj për furnizimin me ujë?




Lidhur me pyetjen a përdorni pompë uji në familje për furnizimin me ujë 20% janë përgjigjur po dhe 80% të tjerë janë shprehur jo.

1/f Keni matës uji?




Lidhur me pyetjen a keni matës uji në shtëpinë tuaj 30% e të intervistuarëve janë përgjigjur po, ndërsa 70% të tjerë janë shprehur jo.

1/g A paguani tarifë për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve?




Në rastin kur banorët janë pyetur a paguajnë tarifë për shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve 90% e tyre janë përgjigjur po, ndërsa 10% të tjerë janë shprehur jo.

1/gj Nëse po, a mendoni se tarifa është e papërbalueshme për nivelin tuaj ekonomik?




Banorët u pyeten se nëse e paguani tarifën, a mendoni se kjo është e përbalueshme, 30% e tyre mendojnë se është e përbalueshme, 15% shprehen se nuk përbën problem, për 20% të të intervistuarve kjo tarifë është e papërbalueshme, ndërsa 35% nuk mund ta paguajnë.

1/h Nëse jo, a do të paguanit tarifë nëse shërbim me ujë e kanalizime do të përmirësohej




Banorët që nuk e paguanin u pyeten a do të paguajnë tarifën nëse shërbimi me ujë dhe kanalizime do të përmirësohej, 100% e tyre u përgjigjën po.

2- Nëse nuk furnizoheni nga sistemi, nga furnizoheni?




Lidhur me pyetjen nëse nuk furnizoheni nga sistemi nga furnizoheni 67% e të anketuarve janë përgjigjur nga burim natyror dhe 33% të tjerë shprehen se furnizohen përmes puseve private.


Lidhur me cilësinë e ujit të intervistuarit janë pyetur për disa nga problematikat që ata mund të kenë gjatë furnizimit me ujë. Disa nga problemet kryesore që parashtrihen nga pyetësi janë: erë e keqe e ujit, shije e keqe e ujit, ujë me ngjyrë, presion i ulët i ujit, temperaturë e ulët (ngirje).



Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me erën e keqe të ujit, 5% e të intervistuarve janë përgjigjur gjithnjë, 30% shprehen se shpesh era e keqe e ujit përbën një problem, 25% shprehen ndonjëherë, 30% e të intervistuarve kanë thënë rrallë, ndërsa 10% shprehen se era e ujit kurrë nuk ka përbërë problem.




Banorët u pyetën në lidhje me shijen e keqe të ujit, 5% e tyre janë përgjigjur se era e keqe e ujit gjithnjë ka përbërë një problem, 30% janë shprehur shpesh herë, 25% janë përgjigjur ndonjëherë shija e keqe e ujit është shfaqur si një problem, rrallë janë përgjigjur rreth 30% e të anketuarve, ndërsa kurrë janë shprehur rreth 10% e të anketuarve.




Kur banorët janë pyetur në lidhje me presionin e ujit, 20% e të intervistuarve janë përgjigjur gjithnjë, 55% e tyre shprehen se shpesh presioni i ujit ka përbërë një problem për ta, 15% janë përgjigjur ndonjëherë, ndërsa 10% të tjerë shprehen se rrallë kanë patur problem me presionin e ulët të ujit.

3/d Ujë me ngjyrë



Në rastin kur banorët janë pyetur në lidhje me ujin me ngjyrë të turbullt, 35% e tyre janë përgjigjur shpesh herë, 25% shprehen se ndonjëherë uji ka qenë me ngjyrë duke përbërë në këtë rast një problem, 20% e të intervistuarve kanë thënë rrallë, ndërsa kurrë janë shprehur rreth 20% e tyre.


3/e Temperatura e ulët (ngrirje)



Përsa i përket pyetjes a keni patur temperatura të ulëta të ujit deri në ngrirje 5% e të anketuarve janë përgjigjur shpesh, 20% ndonjëherë, 40% e tyre janë shprehur rrallë dhe 35% të tjerë kurrë.


Shërbimi i largimit të ujërave të zeza

4/a Largimi i ujërave të ndotur realizohet nëpërmjet




Per pyetjen se si realizohet largimi i ujërave të ndotur qytetarët janë përgjigjur se ky shërbim në masën 5% realizohet nga operatori shtetëror sh.a, 85% realizohet me gropa septike, ndërsa në 10% të rasteve ujrë të ndotura largohen me rrjedhje të lirë.

4/b Sa të kënaqur janë qytetarët me largimin e ujërave të ndotur?



Për pyetjen se sa të kënaqur jeni me largimin e ujërave të zeza, 60% e të intervistuarve janë shprehur deri diku të kënaqur, 40% u përgjigjën se nuk janë fare të kënaqur me këtë shërbim.

5/a Sipas opinionit tuaj, cilat janë tre problemet me serioze?




Gjithashtu banorët janë pyetur se cilat janë sipas tyre tre problemet me serioze me të cilat ndeshet sot zona në fushën e shërbimit me ujë dhe kanalizime.

Rreth 14% e tyre mendojnë se problemi më i madh është që nuk kanë lidhje ujë, 17% mendojnë se nuk ka lidhje (akses) me kanalizimet, 29% mendojnë se uji është i pamjaftueshëm, 21% mendojnë se cilësia e ujit është e papërshtatshme, 19% mendojnë se kushtet higjeno-sanitare janë të papërshtatshme.

7.2. Rezultatet Vlorë

Furnizimi me ujë të pijshëm


1/a Nga cili furnizues e merrni ujin?



- 1- Ndërmarrje shtetëror sh.a
- 2-Nga ndërmarrja e B/K
- 3- Nga ndërmarrje private
- 4- Nga vete komuna apo bashkia
- 5-Tjetër (shëno emrin e furnizuesit)
- 8-Nuk e di
- 9-Pa përgjigje

Kur u pyeten në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm, 100% e të intervistuarve në kuadër të këtij studimi janë përgjigjur se furnizohen nga ndërmarrje shtetërore.


1/b Sa i kënaqur jeni me furnizimin me ujë?



- 1- Shume te kenaqur
- 2-Te kënaqur
- 3- Deri diku te kënaqur
- 4- Aspak te kenaqur
- 8-Nuk e di
- 9-Pa përgjigje

Lidhur me faktin se sa të kënaqur janë ata me furnizimin me ujë të pijshëm, 16% e të intervistuarve u shprehën se janë të kënaqur, 31% e tyre shprehën se janë deri diku të kënaqur, dhe rreth 53% e tyre shprehën aspak të kënaqur.

1/c A përdorni depozitë uji në shtëpinë tuaj?



- 1- PO
- 2-JO
- 8-Nuk e di
- 9-Pa përgjigje


Lidhur me pyetjen a përdorin depozita uji në shtëpitë e tyre 89% e tyre janë përgjigjur po ndërsa 11% jo.

1/d A përdorni pompë uji në familjen tuaj për furnizimin me ujë?




Lidhur me pyetjen a përdorni pompë uji në familjen tuaj për furnizimin me ujë 93% janë përgjigjur po, dhe 7% e tyre janë përgjigjur jo.

1/e Keni matës uji?




Lidhur me pyetjen a keni matës uji rreth 82% e të intervistuarëve janë përgjigjur po ndërsa 18% e tyre janë shprehur jo.

1/f A paguani tarifë për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve?




Në rastin kur banorët janë pyetur a paguajnë tarifë për shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve 86% e tyre janë përgjigjur po, 14% të tjerë janë shprehur jo.

1/g Nëse po, a mendoni se tarifa është e papërballueshme për nivelin tuaj ekonomik?



Banorët u pyetën se nëse e paguani tarifën, a mendoni se kjo është e përballueshme, 75% e tyre mendojnë se është e përballueshme, 13% shprehen se nuk përbën problem, 8% e papërballueshme dhe 4% janë përgjigjur nuk e di.

1/h Nëse jo, a do të paguanit tarifë nëse shërbim me ujë e kanalizime do të përmirësohej?




Banorët që nuk e paguanin u pyetën nëse do të paguanin tarifën nëse shërbimi me ujë dhe kanalizime do të përmirësohej, 50% e tyre u përgjigjën po, 25% jo dhe 25% të tjerë u përgjigjën nuk e di.

2- Nëse nuk furnizoheni nga sistemi, nga furnizoheni?




Të intervistuarve u është bërë pyetja që nëse nuk furnizohen nga sistemi, atëherë nga kush tjetër furnizohen, dhe 100% e tyre janë përgjigjur që nuk kam ujë (e blejmë).

Lidhur me cilësinë e ujit të intervistuarit janë pyetur për disa nga problematikat që ata mund të kenë gjatë furnizimit me ujë. Disa nga problemet kryesore që parashtrihen nga pyetësi janë: erë e keqe e ujit, shije e keqe e ujit, ujë me ngjyrë, presion i ulët i ujit, temperaturë e ulët (ngirirje).




Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me erën e keqe të ujit, 18% e të intervistuarve janë përgjigjur se era e keqe e ujit përbën shpesh një problem, 46% janë shprehur ndonjëherë, 14% e të intervistuarve kanë thënë rrallë, 18% kanë thënë kurrë, ndërsa pjesa tjetër e të intervistuarve prej 4% thonë nuk e di.




Banorët u pyetën në lidhje me shijen e keqe të ujit, 4% e tyre janë përgjigjur se shija e keqe përbën gjithnjë një problem, 25% e tyre shprehen shpesh herë, 32% ndonjëherë, 18% e të intervistuarve kanë thënë rrallë, 7% kurrë, ndërsa pjesa tjetër e të intervistuarve 14% thonë se nuk e dinë.

3/c Presion i ulët i ujit




Kur banorët janë pyetur në lidhje me presionin e ujit, 61% e të intervistuarve janë përgjigjur që gjithnjë presioni i ujit përbën një problem, 25% shprehen se shpesh presioni i ujit përbën një problem, 7% shprehen ndonjëherë dhe 7% të tjerë janë përgjigjur kurrë.

3/d Ujë me ngjyrë




Në rastin kur banorët janë pyetur në lidhje me ujin me ngjyrë të turbullt, 14% e tyre shprehen se shpesh herë uji me ngjyrë përbën një problem për ta, 32% janë shprehur ndonjëherë, 43% e të intervistuarve kanë thënë rrallë, 7% e tyre janë shprehur kurrë, ndërsa pjesa tjetër e të intervistuarve 8% thonë se nuk e dinë.

3/e Temperatura e ulët (ngrirje)




Përsa i përket pyetjes a keni patur temperatura të ulëta të ujit deri në ngrirje që shoqërohen me çarje të tubacioneve, 7% e të intervistuarve janë përgjigjur rrallë, 86% e tyre janë përgjigjur se temperaturat e ulta nuk kanë përbër kurrë një problem për ta ,ndërsa rreth 7% janë shprehur nuk e di.

Shërbimi i largimit të ujërave të zeza




Për pyetjen se si realizohet largimi i ujërave të ndotura, qytetarët janë përgjigjur se ky shërbim në masën 86% realizohet nga operatori shtetëror sh.a., në 4% të rasteve realizohet nga ndërmarrja B/K, 7% janë shprehur se realizohet përmes gropave septike, ndërsa 3% e tyre shprehen nuk e di.



Për pyetjen se sa të kënaqur jeni me largimin e ujërave të zeza, 4% e të intervistuarve janë përgjigjur shumë të kënaqur, 7% e tyre janë shprehur të kënaqur, 11% deri diku të kënaqur, dhe në një masë prej 78% janë shprehur aspak të kënaqur.

5/a Sipas opinionit tuaj, cilat janë tre problemet më serioze me të cilat ndeshet sot qyteti/fshati apo zona juaj në fushën e shërbimit me ujë/kanalizime?



- 1- Nuk ka lidhje (akses) uji
- 2- Nuk ka lidhje (akses) me kanalizimet
- 3- Uji është i pamjaftueshëm
- 4- Cilësia e ujit është e papërshtatshme
- 5- Kushtet higjieno-sanitare janë të papërshtatshme
- 6- Tarifa e ujit dhe kanalizimeve është e papërbalueshme
- 8- Te tjera (specifiko)

Gjithashtu banorët janë pyetur se cilat janë sipas tyre tre problemet më serioze me të cilat ndeshet sot zona në fushën e shërbimit me ujë dhe kanalizime.

Rreth 1% e tyre mendojnë se problemi më i madh është që nuk kanë lidhje uji, 14% e tyre shprehin se nuk kanë akses në kanalizime, 33% mendojnë se uji është i pamjaftueshëm, 23% mendojnë se cilësia e ujit është e papërshtatshme, 22% mendojnë se kushtet higjieno-sanitare janë të papërshtatshme, 1% shprehin se tarifa e ujit dhe e kanalizimeve është e papërbalueshme dhe 6% mendojnë se janë arsye të tjera ku janë renditur këto probleme: Tubacionet e ujit të pijshëm janë të amortizuara; Tubacionet e ujit dhe të ujërave të zeza nuk mirëmbahen; Kanalizimet e ujërave të zeza janë shumë të amortizuara.

Komuna Kaninë


1/a Nga cili furnizues e merrni ujin?



- 1- Ndërmarrje shtetëror sh.a
- 2-Nga ndërmarrja e B/K
- 3- Nga ndërmarrje private
- 4- Nga vete komuna apo bashkia
- 5-Tjetër (shëno emrin e furnizuesit)
- 8-Nuk e di
- 9-Pa përgjigje


Në lidhje me pyetjen nga cili furnizues e merrni ujin 100% e të intervistuarve janë shprehur se e marrin nga ndërmarrja e B/K.

1/b Sa i kënaqur jeni me furnizimin me ujë?




Në lidhje me pyetjen sa i kënaqur jeni me furnizimin me ujë 60% e të intervistuarve janë përgjigjur se janë deri diku të kënaqur, ndërsa pjesa tjetër prej 40% janë shprehur aspak të kënaqur.

1/c A përdorni depozitë uji në shtëpinë tuaj?



Lidhur me pyetjen a përdorin depozita në shtëpitë e tyre 40% e të intervistuarve janë përgjigjur po ndërsa 60% jo.

1/d A përdorni pompë uji në familjen tuaj për furnizimin me ujë?




Lidhur me pyetjen a përdorin pompa në shtëpitë e tyre 20% e të intervistuarve janë përgjigjur po, 80% jo.



Kur u pyeten a keni matës uji 100% e të intervistuarve u përgjigjën po.




Në lidhje me pagesën e tarifës së ujit dhe kanalizimeve 100% e të intervistuarve u shprehen të gatshëm të paguanin tarifën për furnizimin me ujë dhe kanalizime.



Për ata të cilët e paguanin tarifën u shtrua pyetja në është apo jo e përballueshme kjo tarifë dhe 100% e tyre u përgjigjën që është e përballueshme.


1/h Nëse jo, a do të paguanit tarifën nëse shërbim me ujë e kanalizime do të përmirësohej?



- 1- PO
- 2-JO
- 8-Nuk e di
- 9-Pa përgjigje

Për ata të cilët nuk e paguanin u pyetën nëse shërbimi do të përmirësohej a do të paguanit, dhe nga kjo pyetje rezultoi që 100% e të intervistuarve u shprehen pa përgjigje.

2- Nëse nuk furnizoheni nga sistemi , nga furnizoheni?




- 1- Burim natyror
- 2-Puse private
- 3- Çesma publike
- 4- Lidhje te paligjshme
- 5-Te tjera burime
- 6-Nuk kam ujë (e blejmë)
- 8-Nuk e di
- 9-Pa përgjigje

Në lidhje me pyetjen se nëse nuk furnizoheni nga sistemi, atëherë cili është burimi juaj i furnizimit 100% e të intervistuarve u shprehen pa përgjigje.

Përsa i takon cilësisë së ujit me të cilin jeni furnizuar gjatë 12 muajve të shkuar, a keni pasur ndonjë problem me elementët më poshtë, dhe nëse po, a mund të na tregonit sa shpesh shfaqët ky problem?

3/a Erë e keqe e ujit




- Gjithnjë
- Shpesh
- Ndonjëherë
- Rrallë
- Kurrë
- Nuk e di
- Pa përgjigje

Në lidhje me problemin e erës së keqe 60% e të intervistuarve janë përgjigjur gjithnjë era e keqe e ujit është një problem, 20% e tyre janë përgjigjur shpesh dhe 20% të tjerë janë përgjigjur ndonjëherë.




Në lidhje me problemin e shijes së keqe 60% e të intervistuarve janë përgjigjur gjithnjë shija e keqe e ujit është një problem, 20% e tyre janë përgjigjur shpesh dhe 20% të tjerë janë përgjigjur ndonjëherë.




Në lidhje me problemin e presionit të ulët të ujit 60% e të intervistuarve janë përgjigjur gjithnjë presioni i ulët i ujit është një problem, 20% e tyre janë përgjigjur shpesh dhe 20% të tjerë janë përgjigjur kurrë.



Në lidhje me problemin e ujit me ngjyrë 60% e të intervistuarve janë përgjigjur gjithnjë uji me ngjyrë është një problem, 20% e tyre janë përgjigjur ndonjëherë dhe 20% të tjerë janë përgjigjur kurrë.




Në lidhje me pyetjen a ka patur ujë me temperaturë të ulët deri në ngrirje 100% e të intervistuarve janë përgjigjur kurrë.




Në lidhje me pyetjen si bëhet largimi i ujërave të ndotura 60% e të intervistuarve janë përgjigjur me rrjedhje të lire në natyrë dhe 40% janë përgjigjur me gropa septike.

4/b Sa të kënaqur janë qytetaret me largimin e ujërave të ndotur?



Sa të kënaqur janë qytetaret me largimin e ujërave të ndotur 100% e të intervistuarve janë shprehur aspak të kënaqur.

5/a Sipas opinionit tuaj, cilat janë tre problemet më serioze me te cilat ndeshet sot qyteti/fshati apo zona juaj ne fushën e shërbimit me ujë/kanalizime?




Sipas opinionit tuaj, cilat janë tre problemet më serioze me të cilat ndeshet sot qyteti/fshati apo zona juaj në fushën e shërbimit me ujë/kanalizime?

Rreth 13% e të intervistuarve janë përgjigjur nuk ka lidhje uji, 20% nuk ka lidhje (akses) me kanalizimet, 34% uji është i pamjaftueshem, 20% cilësia e ujit është e papershtatshme dhe 13% të tjerë kushtet higjeno-sanitare janë të papershtatshme.


Komuna Nartë

1/a Nga cili furnizues e merrni ujin?



Kur u pyeten në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm, 100% e të intervistuarve janë përgjigjur se furnizohen nga ndërmarrje shtetërore.

1/b Sa i kënaqur jeni me furnizimin me ujë?




Lidhur me faktin se sa të kënaqur janë ata me furnizimin me ujë të pijshëm, 20% e të intervistuarve u shprehën se janë shumë të kënaqur, 20% e tyre të kënaqur, ndërsa 60% e tyre janë shprehur deri diku të kënaqur.

1/c A përdorni depozitë uji në shtëpinë tuaj?




Lidhur me pyetjen se a përdorin depozita uji në shtëpitë e tyre 100% e të intervistuarve janë përgjigjur po.

1/d A përdorni pompë uji në familjen tuaj për furnizimin me ujë?




Lidhur me pyetjen se a përdorin pompa uji në shtëpitë e tyre 100% e të intervistuarve janë përgjigjur po.

1/e Keni matës uji?




Lidhur me pyetjen a keni mates uji 60% e të intervistuarve janë përgjigjur po, ndërsa 40% të tjerë janë përgjigjur jo.

1/f A paguani tarifë për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve?



Në rastin kur banorët janë pyetur a paguajnë tarifë për shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve 100% e tyre janë përgjigjur po.

1/g Nëse po, a mendoni se tarifa është e papërbalueshme për nivelin tuaj ekonomik?



- 1- E përbalueshme
- 2- Nuk përbën problem
- 3- E papërbalueshme
- 4- Nuk mund ta paguani
- 8- Nuk e di
- 9- Pa përgjigje

Banorët u pyeten se nese e paguani tarifen, a mendoni se kjo është e përbalueshme, 60% e tyre mendojnë se është e përbalueshme ndërsa 40% e tyre shprehen se nuk përbën problem.

1/h Nëse jo, a do të paguanit tarifë nëse shërbim me ujë e kanalizime do të përmirësohej?



- 1- PO
- 2- JO
- 8- Nuk e di
- 9- Pa përgjigje

Banorët u pyeten se nëse jo, a do të paguajn tarifën nëse shërbimi me ujë dhe kanalizime do të përmirësohej, 100% e atyre që nuk paguanin u shprehen pa përgjigje.


2- Nëse nuk furnizoheni nga sistemi, nga furnizoheni?




- 1- Burim natyror
- 2- Puse private
- 3- Çesma publike
- 4- Lidhje te paligjshme
- 5- Te tjera burime
- 6- Nuk kam ujë (e blejmë)
- 8- Nuk e di
- 9- Pa përgjigje

Banorët që nuk furnizoheshin nga sistemi u pyeten për burimet e tjera të furnizimit me ujë, por 100% e tyre u shrehen pa përgjigje.


Lidhur me cilësinë e ujit të intervistuarit janë pyetur për disa nga problematikat që ata mund të kenë gjatë furnizimit me ujë. Disa nga problemet kryesore që parashtrohen nga pyetësi janë: erë e keqe e ujit, shije e keqe e ujit, ujë me ngjyrë, presion i ulët i ujit, temperaturë e ulët (ngrirje).




Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me erën e keqe të ujit 40% e tyre janë shprehur se ndonjëherë era e keqe e ujit perben problem, 40% e tyre mendojnë rrallë perben nje problem, ndersa 20% e tyre shprehen kurrë.




Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me shijen e keqe të ujit 20% e tyre janë shprehur se shpesh shija e keqe e ujit përbën problem, 40% e tyre mendojnë se ndonjëherë përbën një problem, 20% shprehen rrallë, ndërsa 20% e tyre shprehen kurrë.



Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me presionin e ulët të ujit 20% e tyre janë shprehur se gjithnjë presioni i ulët i ujit përbën problem, 60% e tyre shprehen shpesh përbën një problem, ndërsa 20% të tjerë shprehen ndonjëherë.




Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me ngjyrën e ujit 20% e tyre janë shprehur se ndonjëherë ngjyra e ujit përbën problem, 60% e tyre shprehen rrallë përbën një problem, ndërsa 20% e tyre shprehen kurrë.



Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me temperaturën e ulët të ujit 100% e tyre janë shprehur pa përgjigje.


4/a Largimi i ujërave të ndotur realizohet nëpërmjet



- 1- Operatori shtetëror sh.a
- 2- Nga ndërmarrja e B/K
Banorët u pyetën se nëse nuk e paguajn tarifën aktuale, a do t'a paguanin tarifën nëse shërbimi me ujë dhe kanalizime do të përmirësohej, 100% e atyre që nuk paguanin u shprehen po.

2- Nëse nuk furnizoheni nga sistemi, nga furnizoheni?




- 1- Burim natyror
- 2- Puse private
- 3- Çesma publike
- 4- Lidhje te paligjshme
- 5- Te tjera burime
- 6- Nuk kam ujë (e blejmë)
- 8- Nuk e di
- 9- Pa përgjigje


Në çdo rast kur banorët nuk furnizoheshin nga sistemi u pyeten për burimet e tjera të furnizimit me ujë, në 34% të rasteve të anketuarit u shrehen se furnizues kryesor i tyre

ishin pusët private, 33% furnizohen nga burime të tjera, ndërsa 33% të tjerë u shprehen nuk kishin ujë, dhe e blinin atë.


Lidhur me cilësinë e ujit të anketuarit janë pyetur për disa nga problematikat që ata mund të kenë gjatë furnizimit me ujë. Disa nga problemet kryesore që parashtrohen nga pyetësi janë: erë e keqe e ujit, shije e keqe e ujit, ujë me ngjyrë, presion i ulët i ujit, temperature e ulët (ngrirje).




Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me erën e keqe të ujit 10% e tyre janë shprehur se gjithnjë ky është një problem që i duhet kushtuar rëndësi, 20% shprehen shpesh, 20% e tyre shprehen ndonjëherë, rrallë janë përgjigjur rreth 10% e të intervistuarve, ndërsa 40% të tjerë janë shprehur kurrë.




Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me shijen e keqe të ujit 10% e tyre janë shprehur se gjithnjë shija e keqe e ujit përbën problem, 60% të tjerë janë përgjigjur shpeshë, 10% mendojnë se rrallë përbën një problem, ndërsa 20% të tjerë shprehen se shija e keqe e ujit lurrë nuk ka bërë një problem.



Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me presionin e ulët të ujit 30% e tyre janë shprehur se gjithnjë presioni i ulët i ujit përbën problem, 30% të tjerë shprehen shpesh, 10% e tyre shprehen rrallë, ndërsa 30% të tjerë kurrë nuk e kanë parë presionin e ulët të ujit si një problem.



Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me ngjyren e ujit 10% e tyre janë shprehur se gjithnjë ngjyra e ujit përbën problem, 10% shprehen shpesh, 20% të tjerë janë përgjigjur ndondjëherë, ndërsa 60% të tjerë shprehen kurrë.




Kur banorët janë pyetur në lidhje me temperaturën e ulët të ujit 10% e tyre janë shprehur se shpesh temperatura e ulët e ujit përbën një problem me rëndësi, 20% janë përgjigjur ndondjëherë, ndërsa 70% janë shprehur se ky faktor rrallë përbën një problem.

4/a Largimi i ujërave të ndotur realizohet nëpërmjet:




Për pyetjen se si realizohet largimi i ujërave të ndotur qytetarët janë përgjigjur se ky shërbim në 10% të rasteve realizohet përmes operatorit shtetërorë, 70% shprehen se ky funksion realizohet nga ndërmarrja e bashkisë apo komunës, në 10% të rasteve realizohet përmes operatorëve privat, ndërsa 10% të tjerë shprehen se realizohet me gropa septike.

4/b Sa të kënaqur janë qytetarët me largimin e ujërave të ndotur?



Për pyetjen se sa të kënaqur jeni me largimin e ujërave të zeza, 10% shprehen se janë shumë të kënaqur, 10% të tjerë shprehen të kënaqur, 20% u përgjigjën se janë deri diku të kënaqur, ndersa 60% shprehen aspak të kënaqur.

5/a Sipas opinionit tuaj, cilat janë tre problemet më serioze me te cilat ndeshet sot qyteti/fshati apo zona juaj ne fushën e shërbimit me ujë/kanalizime?




Gjithashtu banorët janë pyetur se cilat janë sipas tyre tre problemet më serioze me të cilat ndeshet sot zona në fushën e shërbimit me ujë dhe kanalizime.

Rreth 4% e tyre mendojnë se nuk ka lidhje me kanalizimet, 12 % e tyre mendojnë se problemi më i madh është uji i pamjaftueshem, 21% janë shprehur se në problem mbetet cilësia e papërshtatshme e ujit, 38% e të intervistuarve vazhdojnë të shohin si një problem me rëndësi kushtet e papërshtatshme higjieno-sanitare, ndërsa 25% të tjerë shprehen se tarifa e ujit është e papërbalueshme.

Njësia Katund i Ri


1/a Nga cili furnizues e merrni ujin



- 1- Ndërmarrje shtetëror sh.a
- 2-Nga ndërmarrja e B/K
- 3- Nga ndërmarrje private
- 4- Nga vete komuna apo bashkia
- 5-Tjetër (shëno emrin e furnizuesit)
- 8-Nuk e di
- 9-Pa përgjigje

Kur u pyeten në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm, 100% e të intervistuarve janë përgjigjur se furnizohen nga ndërmarrja shtetërore.


1/b Sa i kënaqur jeni me furnizimin me ujë?



- 1- Shume te kenaqur
- 2-Te kënaqur
- 3- Deri diku te kënaqur
- 4- Aspak te kenaqur
- 8-Nuk e di
- 9-Pa përgjigje


Nga ana tjetër me faktin se sa të kënaqur janë ata me furnizimin me ujë të pijshëm, 40% e të intervistuarve u shprehën se janë shumë të kënaqur, 10% të kënaqur, 20% e tyre shprehen se janë deri diku të kënaqur, 20% janë përgjigjur aspak të kënaqur, ndërsa 10% shprehen nuk e di.

1/c A përdorni depozitë uji në shtëpinë tuaj?




Lidhur me pyetjen se a përdorin depozita në shtëpitë e tyre 100% e të intervistuarve janë përgjigjur po.

1/d A përdorni pompë uji në familjen tuaj për furnizimin me ujë?




Lidhur me pyetjen se a përdorin pompa uji në shtëpitë e tyre 90% e të intervistuarve janë përgjigjur po, ndërsa 10% të tjerë janë shprehur jo.

1/e Keni matës uji?




Lidhur me pyetjen a keni matës uji 50% e të intervistuarve në kuadër të këtij studimi janë përgjigjur po, ndërsa 50% të tjerë janë shprehur jo.

1/f A paguani tarifë për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve?




Në rastin kur banorët janë pyetur a paguajnë tarifë për shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve 70% e tyre janë përgjigjur po, ndërsa pjesa tjetër prej 30% janë shprehur se nuk e paguajnë këtë tarifë.

1/g Nëse po, a mendoni se tarifa është e papërbalueshme për nivelin tuaj ekonomik?



Banorët u pyetën se nëse e paguani tarifën, a mendoni se kjo është e papërbalueshme për nivelin tuaj ekonomik, 72% e tyre u shprehen se është e përbalueshme, 14% të tjerë shprehen se tarifa nuk përbën një problem, ndërsa 14% të tjerë e shohin atë si të papërbalueshme.

1/h Nëse jo, a do të paguanit tarifën nëse shërbim me ujë e kanalizime do të përmirësohej?



Banorët u pyetën se nëse jo, a do t'a paguanin tarifën nëse shërbimi me ujë dhe kanalizime do të përmirësohej, 100% e të intervistuarve u shprehën po.


2- Nëse nuk furnizoheni nga sistemi, nga furnizoheni?



Banorët që nuk furnizoheshin nga sistemi u pyetën për burimet e tjera të furnizimit me ujë, 100% e të intervistuarve në këtë rast u shprehen pa përgjigje.


Lidhur me cilësinë e ujit të anketuarit janë pyetur për disa nga problematikat që ata mund të kenë gjatë furnizimit me ujë. Disa nga problemet kryesore që parashtrohen nga pyetësi janë: erë e keqe e ujit, shije e keqe e ujit, ujë me ngjyrë, presion i ulët i ujit, temperaturë e ulët (ngjirje).

3/a Erë e keqe e ujit




Kur banorët janë pyetur nëse era e keqe e ujit përbën një problem për ta, 20% e tyre janë shprehur se ndonjëherë përbën një problem, 20% janë shprehur se era e keqe e ujit nuk ka përbërë kurrë një problem, ndërsa 60% e tyre shprehen nuk e di.


3/b Shije e keqe e ujit




Në rastin që banoret janë pyetur në lidhje me shijen e keqe të ujit 10% e tyre janë shprehur se ndonjëherë shija e keqe e ujit përbën një problem, rrallë shprehen rreth 20% e të intervistuarve, 30% shprehen se kurre shija e keqe e ujit nuk ka përbërë një problem, ndërsa 40% të tjerë shprehen nuk e di.



Në rastin që banoret janë pyetur në lidhje me presionin e ulet të ujit 10% e tyre janë shprehur se gjithnjë presioni i ulët i ujit ka përbërë një problem, 10% shprehen ndonjëherë, 20% të tjerë shprehen rrallë, 20% janë përgjigjur kurrë, ndërsa 10% shprehen nuk e di.




Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me ngjyrën e ujit 10% e tyre janë shprehur se ngjyra e ujit ndonjëherë ka përbërë një problem për ta, 45% janë përgjigjur rrallë, 20% janë shprehur se ngjyra e ujit nuk ka përbërë kurrë problem, ndërsa rreth 30% janë përgjigjur nuk e di.



Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me temperaturën e ulët të ujit rreth 10% e tyre janë shprehur se temperatura e ulët e ujit shpesh ka përbërë një problem duke sjell çarjen e tubave të ujit, 40% janë shprehur ndonjëherë, rrallë janë përgjigjur rreth 10% e të


intervistuarve, 10% të tjerë janë shprehur se temperatura e ujit nuk ka përbërë kurrë problem, ndërsa 30% e tyre janë përgjigjur nuk e di.

4/a Largimi i ujërave të ndotur realizohet nëpërmjet




Për pyetjen se si realizohet largimi i ujerave të ndotur janë përgjigjur se ky shërbim në 40% të rasteve realizohet përmes operatorit shtetëror, 20% e të intervistuarve u shprehën përmes lidhjeve të paligjshme në sistemin e kanalizimeve, ndërsa 40% të tjerë u përgjigjën se largimin e ujrave të ndotura e realizonin përmes gropave septike.

4/b Sa te kënaqur janë qytetaret me largimin e ujërave te ndotur



Për pyetjen se sa të kënaqur jeni me largimin e ujërave të zeza, 40% e të intervistuarve shprehen deri diku të kënaqur me këtë shërbim, ndërsa 60% e tyre janë shprehur se nuk janë aspak të kënaqur mbi mënyrën se si realizohet ky funksion.

5/a Sipas opinionit tuaj, cilat janë tre problemet më serioze me te cilat ndeshet sot qyteti/fshati apo zona juaj ne fushën e shërbimit me ujë/kanalizime?




Gjithashtu banorët janë pyetur se cilat janë sipas tyre tre problemet më serioze me të cilat ndeshet sot zona në fushën e shërbimit me ujë dhe kanalizime.

Rreth 35% e tyre shprehen se nuk kanë lidhje (akses) me sistemin e kanalizimeve, 31% e të intervistuarve shprehen që uji është i pamjaftueshëm, 19% shprehen si një problem me mjaft rëndësi cilësinë e papërshtatshme të ujit, 11% janë përgjigjur se kushtet higjieno-sanitare, ndërsa 4% e tyre shprehen se tarifa e ujit dhe kanalizimeve është e papërbalueshme.


Njësia Maminas

1/a Nga cili furnizues e merrni ujin?




Kur u pyeten në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm, 30% e të intervistuarve janë përgjigjur se furnizohen nga ndërmarrje shtetërore, 10% e tyre shprehen se furnizohen nga ndërmarrje private, 20% shprehen se furnizohen nga ish-komuna apo bashkia, ndërsa 40% shprehen nuk e di.

1/b Sa i kënaqur jeni me furnizimin me ujë?




Lidhur me faktin se sa të kënaqur janë janë banorët me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, 10% e të intervistuarve u shprehën se janë shumë të kënaqur, 10% të tjerë janë përgjigjur të kënaqur mbi këtë shërbim, 40% e tyre janë shprehur aspak te kenaqur, ndërsa 40% të tjerë janë përgjigjur nuk e di.

1/c A përdorni depozitë uji në shtëpinë tuaj?




Lidhur me pyetjen se a përdorin depozita uji në shtëpitë e tyre 80% e të intervistuarve shprehen po, ndërsa 20% e tyre jo.

1/d A përdorni pompë uji në familjen tuaj për furnizimin me ujë?




Lidhur me pyetjen a përdorni pompë uji në familjen tuaj për furnizimin me ujë 80% e të intervistuarve janë përgjigjur po dhe 20% e tyre jo.

1/e Keni matës uji?




Lidhur me pyetjen a keni matës uji 50% e të intervistuarve janë përgjigjur po, ndërsa 50% të tjetër janë shprehur se nuk kanë matës uji në shtëpitë e tyre.

1/f A paguani tarifë për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime?




Në rastin kur banorët janë pyetur a e paguajnë tarifën për shërbimet e furnizimit me ujë dhe te kanalizime 70% e tyre janë përgjigjur po, 10% janë shprehur jo, ndërsa 20% të tjerë janë përgjigjur nuk e di.

1/g Nëse po, a mendoni se tarifa është e papërballueshme për nivelin tuaj ekonomik?




Banorët u pyetën se nëse e paguani tarifën, a mendoni se kjo është e papërballueshme për nivelin tuaj ekonomik, 10% e tyre mendojnë se është e përballueshme, 40% shprehen se është e papërballueshme, 40% të tjerë shprehen se nuk mund ta paguajnë, ndërsa 10% shprehen pa përgjigje.

1/h Nëse jo, a do të paguanit tarifë nëse shërbim me ujë e kanalizime përmirësohej?




Banorët që nuk e paguanin u pyeten a do t'a paguajn tarifën nëse shërbimi me ujë dhe kanalizime do të përmirësohej 100% e tyre u shprehen nuk e di.

2- Nëse nuk furnizoheni nga sistemi, nga furnizoheni?




Lidhur me pyetjen nëse nuk furnizoheni nga sistemi atëherë cili është burimi juaj i furnizimit, 25% shprehen se furnizohen përmes burimeve natyrore, 50% e të aketuarve u shprehen se furnizoheshin nga puset private, 13% janë përgjigjur nuk e di, ndërsa 12% të tjerë janë shprehur pa përgjigje.

Lidhur me cilësinë e ujit të anketuarit janë pyetur për disa nga problematikat që ata mund të kenë gjatë furnizimit me ujë. Disa nga problemet kryesore që parashtrohen nga pyetësi janë: erë e keqe e ujit, shije e keqe e ujit, ujë me ngjyrë, presion i ulët i ujit, temperaturë e ulët (ngrirje).




Në lidhje me problemin e erës së keqe të ujit 30% e të intervistuarve janë përgjigjur se shpesh era e keqe e ujit është një problem, 50% shprehen ndonjëherë, rrallë janë përgjigjur rreth 10%, ndërsa 10% të tjerë janë shprehur kurre.


3/b Shije e keqe e ujit




Në lidhje me problemin e shijes së keqe të ujit 30% e të intervistuarve janë shprehur shpesh, 60% e tyre janë shprehur se ndonjëherë shija e keqe e ujit ka përbërë një problem, ndërsa 10% janë shprehur kurrë.



Në lidhje me problemin e presionit të ulët të ujit 70% e të intervistuarve janë përgjigjur se presioni i ulët i ujit gjithnjë a përbërë një problem, 10% e tyre janë përgjigjur shpesh, ndërsa rreth 20% janë shprehur ndonjëherë.




Në lidhje me problemin e ngjyrës së ujit 30% e të intervistuarve janë përgjigjur se presioni i ulët i ujit gjithnjë ka përbërë një problem, 50% shprehen shpesh, ndonjëherë janë përgjigjur rreth 10% e të intervistuarve, ndërsa 10% të tjerë janë shprehur rrallë.



Në lidhje me problemin e temperaturës së ujit 20% e të intervistuarve janë përgjigjur se temperaturat e ulta të ujit gjithnjë kanë përbërë një problem, 40% janë shprehur shpesh, ndonjëherë janë përgjigjur rreth 10%, ndërsa 30% të tjerë janë shprehur kurrë ky faktorë nuk ka përbërë një problem.


Shërbimi i largimit të ujerave të zeza

4/a Largimi i ujërave të ndotur realizohet nëpërmjet




Për pyetjen se si realizohet largimi i ujërave të ndotur qytetarët janë përgjigjur se ky shërbim në 10% të rasteve sipas të intervistuarve realizohej përmes operatorëve privat, 10% shprehen se largimin e ujrave të ndotura e mundësojnë përmes lidhjeve të paligjshme në sistemin e kanalizimeve, 70% e të intervistuarve i largojnë me gropa septike, ndërsa 10% shprehennuk e di.

4/b Sa te kënaqur janë qytetaret me largimin e ujërave te ndotur



Për pyetjen se sa të kënaqur jeni me largimin e ujërave të zeza, 100% e të anktuarve janë shprehur se nuk janë aspak të kënaqur me këtë shërbim.

5/a Sipas opinionit tuaj, cilat janë tre problemet më serioze me te cilat ndeshet sot qyteti/fshati apo zona juaj në fushën e shërbimit me ujë/kanalizime?




Gjithashtu banorët janë pyetur se cilat janë sipas tyre tre problemet më serioze me të cilat ndeshet sot zona në fushën e shërbimit me ujë dhe kanalizime.

Rreth 8% mendojnë se nuk ka lidhje (akses) ujin, 25% mendojnë se nuk ka lidhje (akses) me kanalizimet, 25% të tjerë mendojnë se uji është i pamjaftueshëm, 17% shprehen se cilësia e ujit është e papërshtatshme, 13% mendojnë që kushtet higjieno-sanitare janë të papërshtatshme, 8% shprehen se tarifa e ujit dhe kanalizimeve është e papërshtatshme, ndërsa 4% shprehen se janë arsye të tjera. Ndër disa specifikimet kryesore janë: Tubacionet e ujit të pijshëm janë të amortizuara, Nuk ka kanalizime të ujërave të zeza.


Njësia Rrashbull

1/a Nga cili furnizues e merrni ujin?




Kur u pyeten në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm, rreth 70% e të intervistuarve shprehen se furnizohen nga ndërmarrja shtetërore, ndërsa 30% të tjerë janë përgjigjur se furnizohen nga vetë ish-komuna apo bashkia.

1/b Sa i kënaqur me furnizimin me ujë?




Lidhur me faktin se sa të kënaqur janë ata me furnizimin me ujë të pijshëm, 20% u shprehen shumë të kënaqur, 20% të tjerë u shprehën të kënaqur, ndërsa 40% e të intervistuarve u shprehen aspak të kënaqur mbi mënyrën se si furnizohen me ujë.

1/c A përdorni depozitë uji në shtëpinë tuaj?




Lidhur me pyetjen se a përdorin depozita në shtëpitë e tyre, 100% e të intervistuarve janë përgjigjur po.

1/d A përdorni pompë uji në familjen tuaj për furnizimin me ujë?




Lidhur me pyetjen a përdorni pompë uji në familje për furnizimin me ujë, 80% e të intervistuarve janë shprehur po, ndërsa 20% shprehen se nuk zotërojnë pompë uji për t'u furnizuar me ujë.

1/e Keni matës uji?




Lidhur me pyetjen a keni matës uji në shtëpinë tuaj 60% e të intervistuarve janë përgjigjur po, ndërsa 40% shprehen se nuk zotërojnë një matës uji në shtëpinë e tyre.

1/f A paguani tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve?




Në rastin kur banorët janë pyetur a paguajnë tarifë për shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve, 80% e tyre janë përgjigjur po, ndërsa 20% të tjerë shprehen se nuk paguajnë një tarifë për shërbimin e furnizimit me uje dhe kanalizime.

1/g Nëse po, a mendoni se tarifa është e papërbalueshme për nivelin tuaj ekonomik?




Banoret u pyeten se nëse e paguani tarifën, a mendoni se kjo është e përbalueshme, 10% e tyre mendojnë se është e përbalueshme, 30% mendojnë se nuk përbën problem, 50% e të intervistuarve shprehen se nuk mund ta paguajn, ndërsa 10% të tjerë shprehen nuk e di.

1/h Nëse jo, a do të paguanit tarifë nëse shërbim me ujë e kanalizime përmirësohej?



Banorët që nuk e paguanin u pyetën a do t'a paguanin tarifën nëse shërbimi me ujë dhe kanalizime do të përmirësohej, 50% e tyre u përgjigjen po, ndërsa 50% të tjerë shprehen se nuk do të paguanin një tarifë për përmirësimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime.


2- Nëse nuk furnizoheni nga sistemi, nga furnizoheni?




Banoret që nuk furnizoheshin nga sistemi u pyeten për burimet e tjera të furnizimit me ujë, 100% e të intervistuarve shprehen se furnizohen përmes puseve private.

Lidhur me cilësinë e ujit të anketuarit janë pyetur për disa nga problematikat që ata mund të kenë gjatë furnizimit me ujë. Disa nga problemet kryesore që parashtrihen nga pyetësi janë: erë e keqe e ujit, shije e keqe e ujit, ujë me ngjyrë, presion i ulët i ujit, temperaturë e ulët (ngrirje).


3/a Erë e keqe e ujit




Në rastin që banoret janë pyetur në lidhje me erën e keqe të ujit 30% e tyre janë shprehur se shpesh era e keqe e ujit përbën problem, 40% janë përgjigjur ndonjëherë, ndërsa 30% shprehen se rrallë era e keqe e ujit ka përbërë një problem për ta.




Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me shijen e keqe të ujit 20% e tyre janë shprehur se shpesh shija e keqe e ujit përbën problem, 50% e tyre shprehen ndonjëherë, rrallë përgjigjen rreth 20% e të intervistuarve, ndërsa 10% të tjerë shprehen se kurrë shija e keqe e ujit nuk ka bërë një problem.



Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me presionin e ulët të ujit 30% e tyre janë shprehur se shpesh presioni i ulët i ujit përbën problem, 40% e tyre shprehen ndonjëherë, rrallë shprehen rreth 20% e të intervistuarve, ndërsa 10% të tjerë shprehen kurrë nuk përbën problem presioni i ulët i ujit.




Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me ngjyrën e ujit 30% e tyre janë shprehur se shpesh ngjyra e ujit përbën problem, 20% e tyre mendojnë ndonjëherë, rrallë shprehen rreth 30% e të intervistuarve, ndërsa 20% të tjerë shprehen se ngjyra e ujit kurrë nuk përbën një problem.




Në rastin që banorët janë pyetur në lidhje me temperaturën e ujit 90% e tyre janë shprehur se rrallë temperatura e ujit ka sjellë një problem, ndërsa 10% të tjerë shprehen kurrë.

Shërbimi i largimit të ujerave të zeza



Për pyetjen se si realizohet largimi i ujerave të ndotur qytetaret janë përgjigjur se ky shërbim në 10% të rasteve realizohet përmes operatorit shtetërorë, 10% të tjerë shprehen se ky funksion realizohet përmes lidhjeve të paligjshme në sistemin e kanalizimeve, me rrjedhje të lirë ujrave të ndotura largohen në 10% të rasteve, ndërsa në masën 70% ky funksion realizohet me gropa septike.

4/b Sa të kënaqur janë qytetarët me largimin e ujërave të ndotur?



Për pyetjen se sa të kënaqur jeni me largimin e ujërave të zeza, rreth 30% e tyre shprehen se janë deri diku të kënaqur, në 50% të rasteve të anketuarit shprehen aspak të kënaqur me mënyrën se si largohen ujrata e ndotura, 10% janë përgjigjur nuk e di, ndërsa 10% të tjerë shprehen pa përgjigje.

5/a Sipas opinionit tuaj, cilat janë tre problemet më serioze me të cilat ndeshet sot qyteti/fshati apo zona juaj në fushën e shërbimit me ujë/kanalizime?



Gjithashtu banorët janë pyetur se cilat janë sipas tyre tre problemet më serioze me të cilat ndeshet sot zona në fushën e shërbimit me ujë dhe kanalizime.

Rreth 8% e tyre shprehen që nuk kanë lidhje uji, 40% mendojnë se nuk ka lidhje (akses) me kanalizimet, 16% mendojnë se cilësia e ujit është e papërshtatshme, në 4% të rasteve të anketuarit shprehen se kushtet higjieno-sanitare janë të papërshtatshme, 28% e tyre shprehen se tarifa e ujit dhe kanalizimeve është e papërbalueshme, ndërsa rreth 4% shprehen se janë probleme të tjera të cilave u duhet kushtuar rëndësi.

8. Aneksi 2: Rezultatet e anketimit të ndërmarrjeve UK të qyteteve në studim mbi gjendjen e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

8.1. Rezultatet Elbasan

- Popullsia totale nën përgjegjesinë e ndërmarrjes -----116.000 banorë
- Volumi i prodhimit vjetor ujëra nëntokësore-----36.391.560 m³/vit
- Impianti i trajtimit të ujit të pijshëm është me klorifikim me një kapacitet 37.066m³/ditë
- Tipi i dezinfektimit klorifikim i lëngshëm në masë----- 100%, klorifikim
- Dezinfektimi bëhet direkt në rrjet me injektim
- Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga tubacione HDPE 202.7 km me vjetërsi 1-10 vjet
- Tubacione gize 11.3 km me një vjetërsi 10-20 vjet
- Tubacione çelik, hekur 58.7 km me vjetërsi 10-30 vjet
- Gjatësia totale e shpërndarjes -----273 km
- Ujë i humbur 78%
- Ujë pa të ardhura 78%
- Numrim i instalimeve të reja në vit 96
- Tarifa e faturimit ujë i matur + tarifë e shështë.

Po paraqësim një tabelë që tregon konsumin vjetor të ujit:

	Nr total i lidhjeve	Bano re/ lidhje	Të matura	Të pama tura	Total	Të faturuara 2014	Faturime vjetore 2014 000leke	Mbledhje vjetore e faturimeve 000leke
Lidhje shërbimi	31137	3.7	19863	11274		3056.73	286.881	274.233
Shtëpiake	279974	4.14	17522	10475		2673479	203496	184911
Përdorim komercial	2973		2182	791		160472	47411	47965
Institucione	167		159	8		222775	35974	41355

Komuna Gjergjan, nga pyetësorët me SHA Ujësjellesit Fshat situata aktuale e furnizimit me ujë është si më poshte:

- Volumi i prodhimit vjetor ujëra nëntokësore-----12960 m³/vit
- Burime të tjera janë pusët dhe burime natyrore
- Impianti i trajtimit të ujit të nuk ka
- Tipi i dezinfektimit klorifikim i lëngshëm
- Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga tubacione HDPE 90 km me vjetërsi 10 vjet
- Ujë i humbur 3888 m³
- Nr instalimeve të reja në vit 30
- Tarifa e lidhjes së re 10.000

Po paraqësim një tabelë që tregon konsumin vjetor të ujit:

	Nr total i lidhjeve	Bano rë/ lidhje	Të matura	Të pama tura	Total	Të faturuara 2014	Faturime vjetore 2014 000leke	Mbledhje vjetore e faturimeve 000leke
Lidhje shërbimi	595							
Shtëpiake	590							
Përdorim komercial	+							
Institucione	-							

Komuna Paper, nga pyetësorët me SHA Ujësjesit Fshat situata aktuale e furnizimit me ujë është si më poshte:

- Volumi i prodhimit vjetor ujëra nëntokesore-----41472 m³/vit
- Impianti i trajtimit të ujit të nuk ka
- Tipi i dezinfektimit klorifikim i lengshem
- Rrjeti i shperndarjes perbehet nga tubacione PCV 125mm 15 vjet, HDPE 115mm me vjetersi 30 vjet ,
- Ujë i humbur 12442m³
- Nr instalimeve te reja ne vit 60
- Tarifa e lidhjes se re 10.000

Po paraqësim një tabelë që tregon konsumin vjetor të ujit:

	Nr total i lidhjeve	Bano rë/ lidhje	Të matura	Të pama tura	Total	Të faturuara 2014	Faturime vjetore 2014 000leke	Mbledhje vjetore e faturi- meve 000leke
Lidhje shërbimi	714							
Shtëpiake	701							
Përdorim komercial	+							
Institucione	-							

Komuna Bradashesh, nga pyetesoret me SHA Ujësjesit Fshat situata aktuale e furnizimit me ujë është si më poshtë:

- Volumi i prodhimit vjetor ujëra nëntokesore-----3.020.000 m³/vit
- Burime të tjera janë puse private
- Impianti i trajtimit të ujit të nuk ka
- Tipi i dezinfektimit klorifikim i lengshem
- Kapaciteti i depozitimit të ujit 1500 m³
- Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga tubacione HDPE 160-180mm me vjetërsi 15 vjet, hekur 75-200mm me vjetërsi 70 vjet
- Ujë i humbur 906000m³
- Nr instalimeve të reja në vit 50
- Tarifa e lidhjes së re 10.000
- Tarifa e faturimit tarifë e sheshtë.

Po paraqësim një tabelë që tregon konsumin vjetor të ujit:

	Nr total i lidhjeve	Bano rë/ lidhje	Të matura	Të pama tura	Total	Të faturuara 2014	Faturime vjetore 2014 000leke	Mbledhje vjetore e faturi- meve 000leke
Lidhje shërbimi	1139							

Shtëpiake	1109							
Përdorim komercial	+							
Institucione	-							

Komuna Shushicë, nga pyetësoret me SHA Ujësjesit Fshat situata aktuale e furnizimit me ujë është si më poshtë:

- Volumi i prodhimit vjetor ujëra nëntokesore-----66120 m³/vit
- Impianti i trajtimit të ujit të nuk ka
- Tipi i dezinfektimit klorifikim i lëngshëm
- Ujë i humbur 19863 m³
- Nr instalimeve të reja në vit 50
- Tarifa e lidhjes së re 10.000

Po paraqësim një tabelë që tregon konsumin vjetor të ujit:

	Nr total i lidhjeve	Bano rë/ lidhje	Të matura	Të pama tura	Total	Të faturuara 2014	Faturime vjetore 2014 000leke	Mbledhje vjetore e faturimeve 000leke
Lidhje shërbimi	1214							
Shtëpiake	1183							
Përdorim komercial	+							
Institucione	-							

Komuna Labinot-fushë, nga pyetësoret me SHA Ujësjesit Fshat situata aktuale e furnizimit me ujë është si më poshtë:

- Popullsia totale nën peregjegjësinë e ndërmarrjes 6720 banorë dhe e shërbyer nga ndërmarrja 6000 banorë.
- Siperfaqja nën përgjegjësinë e ndërmarrjes 2066 km² dhe ajo e mbulimit 1600 km²

- Burime të tjera janë puse private 123 dhe burime në Labinot dhe Griqan
- Impianti i trajtimit të ujit të nuk ka
- Tipi i dezinfektimit klorifikim i lëngshëm
- Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga tubacione hekur 20 0mm me vjetërsi 30 vjet
- Tarifa e lidhjes së re 10.000
- Tarifa e faturimit tarifë e shështë.

Po paraqësim një tabelë që tregon konsumin vjetor të ujit:

	Nr total i lidhjeve	Banorë/ lidhje	Të matur a	Të pamatur a	Total	Të faturuara 2014	Faturime vjetore 2014 000leke	Mbledhje vjetore e faturimeve 000leke
Lidhje shërbimi	453	4,5						
Shtëpiake	441							
Përdorim komercial	-							
Institucione	-							

8.2. Rezultatet Vlorë

Qyteti i Vlores, nga pyetesoret me njësinë vendore Bashkia Vlore dhe SHA Ujësjellesit Vlore, situata aktuale e furnizimit me ujë është si më poshtë:

- Popullsia totale nën përgjegjësinë e ndërmarrjes -----140349 banorë
- Volumi i prodhimit vjetor ujëra nëntokesore-----28.800.000 m³/vit
- Impianti i trajtimit të ujit të pijshëm është me klorifikim me një kapacitet 80.000m³/ditë
- Tipi i dezinfektimit klorifikim i lëngshëm në mase 90%, klorifikim me pluhur në masën 10%
- Rrjeti i shpërndarjes ka një gjatësi prej 446.5km dhe përbëhet nga tubacione HDPE 600mm, 400mm, 315mm, 250mm, 200mm, 160mm me një vjetërsi +5 vjet
- Tubacione gize 80mm, 150mm, 225mm, 300mm me një vjetërsi +50vjet
- Tubacione çelik 700, 500, 400, 300, 200, 225, 150, 80mm me vjetërsi +30vjet
- Kapaciteti i depozitimit të ujit është 14400 m³

Po paraqësim një tabelë që tregon konsumin vjetor të ujit:

	Nr total i lidhjeve	Bano rë/ lidhje	Të matura	Të pama tura	Total	Të faturuar a 2014	Faturime vjetore 2014 000leke	Mbledhje vjetore e faturimeve
Lidhje shërbimi	43601	3.2	843.7	4432.3	5276	278120	129230	193190
Shtëpiake	39418		606.1	3904.9	4511	206560	87100	127760
Përdorim komercial	4050		142.6	348.4	491	51690	24920	38820
Institucione	133		95	179	274	19870	17210	26610

- Përsa i përket ujit të humbur është në vlerën 20.2%
- Uji pa të ardhura 60%
- Forma e faturimit është me ujë të matur dhe me tarifë të sheshtë, punohet me të dyja llojet.
- Numri i instalimeve të reja në vit është 2002
- Numër të aplikimeve të vonuara të palidhura nuk ka.
- Tarifa e lidhjes së re është 5000 lekë për qytetarët dhe 25000 lekë për pallatet e reja +7200leke për çdo qytetarë.
- Koha mesatare e pritjes për një lidhje të re është më pak se 10 ditë.
- Numri i lidhjeve të ndërprera në vit është 500.

Qyteti i Orikut, nga pyetësorët me njësinë vendore Bashkia Vlorë dhe Ndërmarrjes së ujësjellësit Orikum, situata aktuale e furnizimit me ujë është si më poshte:

- Popullsia totale nën përgjegjësinë e ndërmarrjes-----11800 banorë
- Volumi i prodhimit vjetor ujëra nëntokesore-----348.000 m³/vit
- Impianti i trajtimit të ujit të pijshëm është me klorifikim me një kapacitet 966 m³/ditë
- Tipi i dezinfektimit klorifikim me pluhur në masën 100%
- Rrjeti i shpërndarjes ka një gjatësi prej 20km dhe përbëhet nga tubacione HDPE me një vjetërsi +5 vjet,
- Tubacione gize +50vjet
- Tubacione çelik
- Përsa i përket ujit të humbur është në vlerën 30 %
- Uji pa të ardhura 60%

- Forma e faturimit është me tarifë të sheshtë.
- Numri i instalimeve të reja në vit është 10
- Numër të aplikimeve të vonuara të palidhura nuk ka.
- Tarifa e lidhjes së re është 7200 lekë
- Koha mesatare e pritjes për një lidhje të re është më pak se 10 ditë.
- Numri i lidhjeve të ndërprera në vit është 120.

Po paraqësim një tabelë që tregon konsumin vjetor të ujit:

	Nr total i lidhjeve	Banor ë/ lidhje	Të matura	Të pama tura	Total	Të faturua ra 2014	Faturime vjetore 2014 000leke	Mbledhje vjetore e faturimeve 000leke
Lidhje shërbimi	1940			1940		210000	6687	5964
Shtëpiake	1870			1870		204000	6204	5676
Përdorim komercial	67			67		3600	287	288
Institucion e	3			3		2400	196	

Komuna Novosele nga pyetësorët me njësinë vendore Komuna Novosele dhe Ndërmarrjes së ujësjellësit SHA Novosele, situata aktuale e furnizimit me ujë është si më poshtë:

- Popullsia totale nën përgjegjësinë e ndërmarrjes-----12039 banorë
- Volumi i prodhimit vjetor ujëra nëntokesore-----900.000 m³/vit
- Impianti i trajtimit të ujit të pijshëm është me klorifikim me një kapacitet 2500 m³/ditë
- Tipi i dezinfektimit klorifikim të lëngshëm me kapacitet depozitimi i ujit 360m³
- Rrjeti i shpërndarjes ka një gjatësi prej 78.5km dhe përbëhet nga tubacione HDPE me një vjetërsi +5 vjet,
- Tubacione gize +50vjet
- Tubacione çelik +25 vjet
- Përsa i përket ujit të humbur është 187000 m³/vit
- Uji pa të ardhura 432418 m³/vit
- Forma e faturimit është me tarifë të sheshtë, ujë i matur.
- Numri i instalimeve të reja në vit është 6

- Numër të aplikimeve të vonuara të palidhura nuk ka.
- Tarifa e lidhjes së re është 10000 leke familjet, 15000 privati
- Koha mesatare e pritjes për një lidhje të re është 10 ditë.

Po paraqësim një tabelë që tregon konsumin vjetor të ujit:

	Nr total i lidhjeve	Banor ë/ lidhje	Të matura	Të pama tura	Total	Të faturua ra 2014	Faturime vjetore 2014 000leke	Mbledhje vjetore e faturi-meve 000leke
Lidhje shërbimi	2299		109	2190		20635	11825	
Shtëpiake	2219		107	2112		16281	7586	
Përdorim komercial	78		2	76		4000	3823	
Institucione	2					278	340	278

Komuna Qënder nga pyetesoret me njësinë vendore Komuna Qendër dhe Ndërmarrjes së ujësjellesit, situata aktuale e furnizimit me ujë është si më poshtë:

- Popullsia totale nën përgjegjësinë e ndërmarrjes-----18661 banorë
- Volumi i prodhimit vjetor ujëra nëntokesore-----216000 m³/vit
- Ujëra sipërfaqësore 43200 m³/vit
- Ka shumë puse
- Impianti i trajtimit të ujit të pijshëm është me klorifikim
- Tipi i dezinfektimit klorifikim pluhur në masen 100%
- Rrjeti i shpërndarjes ka një gjatësi prej 78.5km dhe përbëhet nga tubacione HDPE 200 mm me një vjetërsi +5 vjet,
- Tubacione gize +50vjet
- Tubacione çelik 100, 125, 200 mm +25 vjet
- Uji i humbur 30%
- Uji pa të ardhura 40%

	Nr total i lidhjeve	Banor ë/ lidhje	Të matura	Të pama tura	Total	Të faturua ra 2014	Faturime vjetore 2014 000leke	Mbledhje vjetore e faturi-meve 000leke
--	---------------------	-----------------	-----------	--------------	-------	--------------------	-------------------------------	--

Babicë	530			95000	95000	265000	3180000	
Xhyherin	29			5800	5800	14500	174000	
Sherishtë	100			20000	20000	50000	600000	

8.3. Rezultatet Gjirokaster

Shoqëria UK Qytet Gjirokastrë dhe të dhënat për ofrimin e shërbimeve:

- Ndërmarrja në fjalë/shoqëria është përgjegjëse dhe për prodhim dhe shpërndarje të ujit të pijshëm. Ndërsa sipas vërtetimit të realizuar Shoqëria UK është pjesërisht përgjegjëse për shërbimet e ujërave të zeza dhe largimin e tyre.
- Përgjegjësia e saj është të mbulojë më shërbim gjithë qytetin, ndërsa mbulon me shërbim dhe fshatrat Valare, Topullaraj, Shen Todër, Asim Zeneli, dhe Arshi Lengo.
- Popullsia që shoqëria ka në juridiksion për të furnizuar më ujë është 38 300 banorë. Ndërsa shoqëria arin të ofrojë shërbime vetëm për 34 100 banorë.
- Uji sigurohet nga burimet: Hos me 2 300 000 m kub/vit; Tranoshisht 1 600 000 mkub/vit; Buduk 1750000 m kub në vit. Uji sipas shoqërisë i nënshtrohet klorifikimit me pluhur. Në tërësi gjatësia totale e shpërndarjes është 63 km nga ku 40 km është gjatësia e linjave nga burimet në depo.
- Klorifikimi nga ndërmarrja realizohet me pluhur dhe specialistët nuk deklarojnë % e përdorimit të klori për m kub.
- Për sa i përket rrjetit të shpërndarjes materialet që shoqëria përdor janë: Pvc 250 mm me një vjetërsi 15 vjecare; gize dhe hekur 150 – 70 mm me vjetërsi 60 vjecare.
- Në lidhje me tarifimet shoqëria aplikon të dy llojet e matur dhe e sheshtë. Lidhjet e shërbimit të matura janë 80 ndërsa të pamatura 6498. Lidhjet familjare të matura 38 ndërsa të pamatura 8448. Tarifa e aplikuar për lidhjet e reja në zonën ku operon shoqëria janë 13 046 lekë dhe shërbimi lidhet brenda një afati prej 15 ditësh. Sipas shoqërisë numri i ndërprerjeve në viti është 540.

Ndërmarrja Ujsësjellës Fshat

- Kjo ndërmarrje është përgjegjëse vetëm për shpërndarje dhe arrin të mbulojë më shërbim një popullsi prej 1540 banorësh kryesisht komunat Odrie, Libohovë dhe Komuna Qëndër.
- Klorifikimi nga ndërmarrja realisohet dhe me pluhur dhe me lëng. Gjatësia totale e shpërndarjes është 140 km dhe materiali i përdorur në tubacione është hekur diam 80 mm me një moshë mbi 20 vjecare.
- Zyrtarisht ndërmarrja ka vetëm 240 lidhje shërbimi dhe 240 lidhje familjare ndërsa ofron dhe vetëm një lidhje të furnizimit me shumicë për Komunën Dropull.
- Lidhjet e reja dhe tarifa e tyre është 5000 lekë të reja dhe në një afat prej 5 ditësh

Komuna Picar

- Komuna Picar ofron shërbim shpërndarje uji dhe nuk ofron shërbim largimi të ujrave të ndotur. Ka në përgjegjësi gjithë komunën ndërsa popullsia që deklarohet se merr shërbim është 1600 banorë.
- Burim kryesor për Komunën është burimi i Rehovës dhe kapacitetet e ujit të ofruar janë në tërësi 7 litra për sekondë për gjithë sistemin.
- Specialistët e komunës deklarojnë se realizojnë klorifikim jo mbi baza të rregullta dhe se mungon filtrimi me shtresë rëre. Nuk ofrohet process Cklorifikimi. Komuna në pronësi të saj ka depozita 60 m kub dhe 24 m kub.
- Rrjeti i tubacioneve nga burimet në grumbullim është 7 km. Rrjeti i brendshëm furnizues shkon në 10 km. Materiali i përdorur është pjesërisht PVC dhe në shumicë gize dhe hekur. Sipas komunës në komunitet ka rreth 140 depozita uji.

Komuna Cepo

- Komuna ka në përgjegjësi për të mbuluar me shërbim gjithë territorin e komunës. Shërbimi që ajo ofron është prodhimi dhe shpërndarja ndërsa pjesërisht dhe shërbimet kanalizime. Popullsia nën përgjegjësi dhe që duhet ti ofrohet shërbim është 2100 banorë. Burimet kryesisht janë natyrore dhe ka prani të ujrave nëntokësore.
- Kapacitetet e burimeve të përdorura janë 3; 4 dhe 6 litra për sekondë.
- Klorifikimi realizohet me klor me klor pluhur por nuk deklarohet % e përdorur.
- Sistemi i tubacioneve është i vitete 70 (gizë dhe hekur) dhe në vitet 2000 ka pasur ndërhyrje rinovuese (PVC). Nga burimet deri në grumbullim 15 km dhe rrjeti i brendshëm 18 km.
- Popullsia nën përgjegjësi të komunës është 2100 banorë dhe identifikohen 170 depozita private.

Komuna Lazarat

- Komuna Lazarat ofron për banorët e saj shërbime të prodhimit dhe shpërndarjes. Ndërsa Komuna nuk ofron shërbim të largimit të ujrave të zeza.
- Popullsia që komuna ka nën juridiksion është 3000 banorë.
- Nuk deklarohet procedura e klorifikimit dhe tarifime
- Gjatësia totale e sistemit të shpërndarjes është 10 km dhe sipas specialistëve sistemi i shpërndarjes ka një vjetërsi 10
- vjecare me PVC 140 – 50 m.

Komuna Antigone

- Komuna Antigone përfshin 5 fshatra në adminsitrim Arshi Lengo, Asim Zenel ,Krine, Tranoshishte dhe Saraqinishte
- Popullsia që komuna ka nën juridiksion është 1850 banorë.
- Uji i siguuruar për shpërndarje sigurohet me anë të burimeve. 3 burime kryesore:
 - o Tranoshishta ka kapacitet 22 litër/sek, dhe,
 - o Saraqinishta janë të pamatshme.
- Uji klorifikohet me standartin në vend.
 - o Asim Zenel 2 depo nga 75 m³ secila .
 - o Arshi Lengo 1 depo 100 m³ .

- o Tranoshishte 1 depo 20 m³ .
- o Saraqinishte 2 depo njera 50 m³ dhe tjetra 20 m³ .
- o Krina ska depo është me rjedhje te lire .
- Tubot janë xingato me diameter 2” (poleshe) dhe plastike me diameter 50 ø,63ø dhe 75ø (fi).
- Nuk ka informacion per gjatësin e rrjetit
- 100% e popullsis mbulohen me sherbim.
- Banorët janë te detyruar te paguajne tarife te shështë.

8.4. Rezultatet Pogradec

Në qytetin e Pogradecit dhe në disa nga fshatrat e Komunës Bucimas bëhet furnizimi me ujë të pijshëm për 24 orë për të gjitha familjet. Është ndërtuar një sistem modern i ujit të pijshëm që nga grumbullimi i tij që bëhet në kaptazh e deri në gjithë rrjetin e brendshëm shpërndarës që përfundon në çezmat e konsumatorëve. Bëhet klorinimi i përditshëm i ujit të pijshëm me pikim automatik. Bëhet monitorimi i ujit të pijshëm i përditshëm në 10 pika fundore të rrjetit për ngarkesë mikrobiale dhe për nivelin e klorit në ujë. Nuk ka pasuar asnjë rast të kontaminimit të ujit të pijshëm. Për qytetin e Pogradecit nuk ka probleme me furnizimin me ujë të pijshëm, si nga sasia që nevojitet për të gjitha familjet dmth 24 orë në ditë, po ashtu duke qënë ujë higjenikisht i pastër e i kontrolluar laboratorikisht.

Ndermarrja e Ujësjetllësit Pogradec mbulon me furnizim me ujë të pijshëm, jo vetëm qytetin e Pogradecit, por edhe fshatrat Tushemisht, Gurras, Buçimas, Vërdovë, dhe po punohet për të shtrirë rrjetin edhe në Gështenjas dhe Bacallëk.

Në fshatrat kryesisht i gjithë rrjeti është ose po vendoset i ri, pasi rrjeti i vjetër edhe aty ku ekzistonte pothuaj ishte jashtë funksionit. Matësat e rinj ëireless po vendosen në të gjitha fshatrat duke bërë kështu edhe evidentimin e klientëve te cilët lidhin kontratat e reja, kurse personave që janë debitorë u kërkohet më parë shlyerja e detyrimit.

Problematiche ka qënë situata në fshatin Gështenjas dhe Bacallëk, pasi në këtë zonë nuk ka fare furnizim me ujë, dhe ndërkohë vazhdon të bëhet faturimi afrofe. Kjo është një çështje që duhet zgjidhur. Me fazën e III-te ka filluar puna për ndërtimin e rrjetit të ri në keto 2 fshatra , rehabilitimin e depos ekzistuese në Gështenjas dhe ndërtimin e 2 depove të reja për pjesën e poshtme të Gështenjasit dhe për Bacallëkun. Nga fondi prej 3.5 mil euro për këtë investim, do realizohet edhe stacioni I ri I pompimit të ujrave të përdorura për fshatin Bucimasi dhe rrjet kolektori për këtë fshat.

Cilësia e ujit

Është punuar në 2 drejtime:

1. Monitorimi i ujit të pijshëm për të garantuar për cilësinë dhe pastërtinë e tij- Duke bërë edhe monitorim të përditshëm për praninë e klorit dhe ngarkesën mikrobiale në rrjetin që furnizohet nga burimi i Tushemishtit dhe i Gurrasit, edhe monitorimin e cilësisë të ujit të pijshëm në burim dhe në rrjet përsa i përket parametrave si: Treguesit shqisorë, Fiziko-kimikë, Kimikë dhe

Mikrobiologjikë. Kështu është kryer procesi i klorinimit të ujit dhe nga testet për prani të klorit kanë rezultuar nivelet 0.2-0.3 mg/l. Testet për prezencë mikrobiologjike kanë rezultuar negative. Nga analizat del se uji është i një niveli të mirë dhe në përputhje me standartin shtetëror dhe vlerat e parametrave të monitoruara janë të pranueshme.

2. Menaxhimi teknologjik i punës së IPUP dhe monitorimi i përbërësve të ujit në hyrje, në dalje dhe në proceset kryesore të impiantit.- Prurjet e ujit të ardhura janë mesatarisht 4680 m³/ditë. Nga analizat e kryera del se uji në dalje të impiantit është i një cilësie të mirë dhe në përputhje me standartin VKM 177 datë 31.03.2005. Analizat kryhen pas çdo procesi dhe me një frekuencë të përcaktuar.

Komuna Çërravë

Në juridiksionin e saj ndodhen 11 fshatra të cilat kanë problematika të theksuara për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm.

1. Fshati Çërravë e Qërshizë furnizohen me ujë të pijshëm me 2 orë në ditë familjet e këtyre fshatrave. Ky ujësjellës nuk i plotëson nevojat për të gjitha familjet e këtyre fshatrave pasi ka rrjet të brendshëm të furnizimit me ujë tejet të amortizuar. Si pasojë e amortizimit të këtij rrjeti humbjet e ujit shkojnë në masën 50%. Ky ujësjellës administrohet dhe mirëmbahet nga komuna Çërravë. Të ardhurat e grumbulluara nga ky ujësjellës nuk mbulojnë shpenzimet e energjisë dhe të punonjësve që merren me administrimin e tij. Këto janë dhe arsyt që komuna nuk ka bërë ndërhyrje në rikonstruksionin total të këtij ujësjellësi.

2. Fshati Pretushë, Nizhavec, Leshnicë kanë furnizim të pjesshëm me ujë në masën 30% të popullsisë të këtyre fshatrave. Burimet e ujit për këta ujësjellës janë disa shpime pusi të kryera me sonde të cilat kanë rezerva të pakta për një furnizimin tërësor gjë që ka kushtëzuar edhe zgjerimin e rrjetit për furnizim me ujë për të gjithë banorët.

3. Ndërsa për fshatrat Blace, Bletas, Alarup, Lumas, Kodras nuk kanë fare ujësjellës. Zgjidhja e vetme për këta banorë të këtyre fshatrave për t'u furnizuar me ujë janë disa burime nëntokësore që ndodhen në këto fshatra. Gjatë verës popullsia e këtyre fshatrave vuajnë mungesën e ujit të pijshëm për shkak se rezervat e burimeve nëntokësore shterojnë.

Komuna Hudënisht

Në të gjitha fshatrat e kësaj komune ka ujësjellës. Furnizimi me ujë të pijshëm për familjet e këtyre fshatrave bëhet me orar jo më shumë se 4-5 orë në ditë. Nga kontrollet e bëra nuk ka pasuar kontaminime të ujit të pijshëm. Në disa raste nuk bëhet klorinimi i rregullt i ujit të pijshëm në depozitat e këtyre fshatrave. Për arsye të mungesës së klorit dhe blerjes së tij nga komuna për shkak të fondeve të pamjaftueshme që kanë. Depozitat e ujit në fshatrat e komunës Hudënisht në përgjithësi janë të mira. Po në disa raste janë depozitat janë vogla dhe uji i grumbulluar nuk mjafton që të gjitha familjet të kenë ujë me orar të plotë.

8.5. Rezultatet Durrës

Furnizimi me ujë Durrës

Ndërmarrja	Prodhim	Shërndarje	Largimi i ujrave të përdorur	Mbulimi	Detaje te mbulimit	Ujra nëntokësorë të matur m3	blerje e ujit me shumice - trajtuar	Gjatesia totale e shperndarjes KM
UKD	Po	Po	Po	Të gjithë zonën	Durres, Bashkia Sukth, Manz, Shijak, Komunat: Katund i Ri, Rrashbull, Ishëm, Maminas, Gjepalaj, Xhafzotaj, Fushë Kuqe, Preze. Fshatrat: Shetel, Çezmelli, Eminas	27,000,000	360,000	640

Popullsia	Mbuluar	Sherbyer	%	Krahasuar me anketimin qytetar
	330,000	280,000	85%	81%
Lidhjet	total	Matur	%	
funksionale	76,000	50,000	66%	75%
Shtepiake	71,000	45,000	63%	

Furnizimi me ujë Maminas

Ndërmarrja	Prodhim	Shërndarje	Largim i ujrave të përdorur	Mbulimi	Detaje te mbulimit	Ujra nëntokësorë të pamatur m3	Gjatesia totale e shperndarjes KM
UKD Shijak (MAMINAS)	Po	Po	Jo	Të gjithë zonën	Vore Marikaj (vetem biznese)	180,000	10

Popullsia	Mbuluar	Sherbyer	%	Krahasuar me anketimin qytetar	cilesia e sherbimit	Burime te tjera te perdorur nga qytetaret
	20,000	7,500	38%	30%	40% aspak te kenaqur	60%
Lidhjet	total	Matur	%		te tjera	Puse
Funksionale	320	175	55%	50%	900	200
Shtepiake	320	175	55%			

9. Aneksi 3: Foto nga aktivitetet













































































